



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

RAPORT VJETOR
MARS 2013





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

I AGJENSISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR PARLAMENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MARS 2013

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	3
DEKLARATA E KRYETARIT.....	5
MANDATI, ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI.....	7
STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	8
AKTIVITETET E AGJENCISË.....	8
DIVIZIONI I SHITJES.....	10
DEPARTAMENTI I SHITJES.....	10
PROJEKTET INDIVIDUALE.....	11
SHITJET PËRMES SPIN-OFF.....	12
SHITJA E ASETVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE NË LIKUIDIM.....	12
KONTRATAT.....	13
LISTAT E NDËRMARRJEVE NË ADMINISTRIM TË DREJTPËRDREJTË.....	14
NJËSIA PËR KONTROLL DHE MBIKËQYRJE.....	27
NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITORË.....	33
DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT.....	36
DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT.....	36
NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA.....	36
AUTORITETI I LIKUIDIMIT – OFRUESIT E SHËRBIMEVE PROFESIONALE.....	37
NJËSIA E LIKUIDIMIT TË NSH-VE NGA AKP.....	39
NJËSIA E LISTAVE TË PUNËTORËVE.....	40
NJËSIA E TRANZICIONIT.....	50
DEPARTAMENTI I KOORDIMIT RAJONAL.....	50
PRIVATIZIMI.....	51
LIKUIDIMI.....	51
SFIDAT.....	51
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	52
NJËSIA PËR REGJISTRIMIN E ANKESAVE.....	52
NJËSIA PËR PËRFAQËSIME NË GJYKATË.....	52
NJËSIA PËR OPINIONE LIGJORE.....	53
KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË LISTAVE TË PUNËTORËVE (KSHALP).....	53
KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË PRONËSI TË NSH-VE.....	53
NJËSIA PËR RIORGANIZIMIN E TREPÇËS.....	54
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	59
SHTOJCAT	
1.1 PASQYRAT FINANCIARE TË LLOGARIVE TË AGJENCISË.....	61
1.2 VEÇMAS NGA LLOGARITË E AGJENCISË, PASQYRAT FINANCIARE TË LLOGARIVE DHE ASETVE TË CILAT MBAHEN NGA AGJENCIA NË MIRËBESIM.....	81
1.3 LISTA E NDËRMARRJEVE QË JANË VËNË NËN ADMINISTRIMIN E DREJTPËRDREJTË TË AGJENCISË NË PAJTIM ME NENIN 6.1.....	175
1.4 LISTA E TRANSAKSIONEVE TË KRYERA SIPAS NENIT 8 TË REALIZUARA GJATË VITIT PËR TË CILIN RAPORTOHET DHE TRANSAKSIONET E MBETURA PEZULL.....	177
1.5 LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA SIPAS NENIT 9.....	181
1.6 LISTA E NDËRMARRJEVE NDAJ TË CILAVE ËSHTË FILLUAR PROCEDURA E RIORGANIZIMIT.....	183

LISTA E SHKURTESAVE

AD – Administrimi i Drejtpërdrejtë
 AL – Autoriteti i Likuidimit
 AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit
 APIK – Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
 BiD – Bordi i Drejtorëve
 CLOR – Rreziqe të caktuara ligjore dhe tjera
 DL – Departamenti Ligjor
 GP – Grupi Punues
 IKAP – Instituti Kosovar për Administratë Publike
 KB – Kooperativa Bujqësore
 KSHLP – Komisioni për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve
 LMFPP – Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
 MAP – Ministria e Administratës Publike
 MBPZHR – Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
 MFGJ – Ministria Federale e Financave Gjermane
 MISHAL – Memorandum Informimi për Shitje të Aseteve me Likuidim
 MZHE – Ministria për Zhvillim Ekonomik
 Ndër e Re – Ndërmarrje e Re
 NJAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm
 NJKM – Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje
 NJOL – Njësia për Opinione Ligjore
 NJPGJ – Njësia për Përfaqësime në Gjykata
 NJRA – Njësia për Regjistrimin e Ankesave
 NJSHA – Njësia për Shqyrtimin e Ankesave
 NSH – Ndërmarrje Shoqërore
 OEK – Oda Ekonomike e Kosovës
 OSHP – Ofruesi i Shërbimeve Profesionale
 DhPGJS – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
 SDR – Kërkesë për Përcaktimin e Statusit
 SHA – Shoqëri Aksionare
 SHAL – Shitja e Aseteve përmes Likuidimit
 SHPK – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
 SORr – Spin Off i Rregullt
 SOS – Spin Off Special
 ZR – Zyra Rajonale

DEKLARATA E KRYETARIT

I nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Bordi i drejtorëve me këtë rast paraqet Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin kalendarik 2012, si obligim i dalë nga neni 20, pika 20.1 të Ligjit për AKP-në, i cili përfshinë:

- 1.1 Pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- 1.2 Veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve e cila mbahet nga Agjencia në mirëbesim;
- 1.3 Listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1;
- 1.4 Listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- 1.5 Listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- 1.6 Listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

Siç jeni në dijeni, më 14 qershor 2012, Agjencia ka humbur Kryesuesin e Bordit, të ndjerin z. Dino Asanaj. Vdekja tragjike e të ndjerit tronditi pafundësisht stafin e AKP-së dhe cungoi institucionin e AKP-së në përmbushjen e minisionit të saj. Kryetari i ndjerë ishte një vizionar i madh i cili me punë, vetëmohim dhe energji të jashtëzakonshme arriti të udheheq ndryshimet që trasuan rrugën për përmbyllje procesit në të mirë të Kosovës. Vullneti dhe guximi i tij buronte nga idealet për vendin e vet. Agjencia mbetet e përkushtuar në përmbushjen e vizionit të kryetarit të saj të ndjerë dhe do të angazhohet maksimalisht për të përfunduar misionin e saj me sukses.

Po ashtu, ju lutem keni parasysh që Bordi i Drejtorëve si tërësi e ka përfunduar mandatin efektivisht prej 22 korrikut të vitit 2012 pas skadimit të mandatit të Drejtorëve vendor, deri më 21 shkurt të vitit 2013 kur Kuvendi i Kosovës emëroi anëtarët vendorë të Bordit të Drejtorëve. Gjatë kësaj periudhe aftësia e Agjencisë për të operuar sipas mandatit të saj ka qenë jashtëzakonisht e kufizuar në kryerjen e mandatit të saj dhe të realizimit të planit të punës. Më shumë se gjysma e anëtarëve të tanishëm të Bordit të Drejtorëve nuk kanë qenë anëtarë të Bordit gjatë vitit 2012, vit për të cilin raportohet.

Skender Komoni



Zëvendës Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Maj, 2013

MANDATI, ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

Agjencia Kosovare e Privatizimit themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 04/L-034, mbi AKP-në. AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padis e të paditet në emër të saj. Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorë Menaxhues, Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive si dhe personelin profesional dhe teknik.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së përbëhet nga tetë Drejtorë, pesë (5) të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe tre (3) anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në përputhje me dispozitat e Ligjit për AKP-në. Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me ligj. Bordi ushtron të gjitha kompetencat e Agjencisë, përveç atyre të cilat mund t'ia delegoj Menaxhmentit.

Mandatet e pesë drejtorëve vendorë të Bordit kanë skaduar në prill, respektivisht qershor dhe korrik dhe zëvendësimet nuk janë bërë deri me 21 shkurt 2013, që do të thotë se gjatë kësaj kohe Bordi i Drejtorëve nuk ka pasur kuorum prej 22 korrikut e deri me 21 shkurt 2013 dhe si pasojë e kësaj Bordi nuk ka mundur t'i kryejë përgjegjësitë e veta duke vështirësuar aktivitetet e Agjencisë gjatë kësaj periudhe.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së gjatë vitit 2012 ishte në këtë përbërje:

- Dino Asanaj – Kryesues dhe Drejtor (22.07.2010 – 14.06.2012)
- Naser Osmani, Zëvendës – Kryesues dhe Drejtor (29.04.2010 – 28.04.2012)
- Bahri Shabani, Drejtor (22.07.2010 – 21.07.2012)
- Bernadette Roberts, Drejtor (27.08.2012 – 31.08.2014)

- Haxhi Arifi, Drejtor (22.07.2010 – 21.07.2012)
- Hubert Warsmann, Drejtor (06.12.2010 – 05.12.2010, riemëruar me 26.06.2012 – 31.08.2014)
- Lisa Brodey, Drejtor (30.03.2011 – 26.08.2012)
- Dr. Mohammed Omran, Drejtor (06.12.2010 – 05.12.2010, riemëruar me 26.06.2012 – 31.08.2014)
- Slobodan Petrovič, Drejtor (22.07.2010 – 21.07.2012)
- Radica Nusdorfer, Vëzhgues – zëvendësuar nga Michele Moran – Vëzhgues

Duke konsideruar që ky raport shërben po ashtu edhe si vegël në funksion prezantues, më poshtë është lista e plotë e anëtarëve të Bordit të cilët operojnë momentalisht:

- Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha, Kryesues (21.02.2013 – 20.02.2016)
- Skënder Komoni, Zëvendës Kryesues (21.02.2013 – 20.02.2015)
- Bernadette Roberts (27.08.2012 – 31.08.2014)
- Dardane Peja, Drejtor (21.02.2013 – 20.02.2015)
- Haxhi Arifi, Drejtor (21.02.2013 – 20.02.2015)
- Hubert Warsmann, Drejtor (26.06.2012 – 31.08.2014)
- Maja Milanovic, Drejtor (21.02.2013 – 20.02.2015)
- Dr. Mohammed Omran (26.06.2012 – 31.08.2014)
- Michelle Moran – Vëzhgues

Gjatë vitit 2012 Bordi ka mbajtur gjithsejtë tetë (8) mbledhje mujore. Çështjet kryesore me të cilat është marrë Bordi gjatë kësaj periudhe kanë qenë: restrukturimi i Agjencisë, shpërndarja e pjesës së 20% për punëtorët, angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për Autoritet të Likuidimit që do të punoj më intensivisht në përshpejtimin e likuidimit të portfolios së ndërmarrjeve shoqërore, çështja e zgjedhjes së pesë (5) rasteve të Spin Off-eve Speciale të ndëshkuara, ku në dy prej pesë rasteve ka vendos për tërheqje të aksioneve; Bordi poashtu ka qenë i angazhuar në diskutim dhe aprovim të Valëve të privatizimit dhe poashtu Shitjeve përmes Likuidimit.

SHËNIM:

Mandati i anëtarëve vendor të Bordit ka skaduar me datë 22 korrik 2012, kurse mandati i anëtarëve ndërkombëtar të Bordit është vazhduar deri me 31 gusht 2014. Bordi në kohën e raportimit nuk ka mandat/kuorum për t'u takuar, respektivisht janë vetëm 3 anëtarët ndërkombëtarë të Bordit.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Menaxhmenti i AKP-së në vitin 2011 ka bërë planin e riorganizimit dhe ristrukturimit të Agjencisë i cili ka filluar të zbatohet në fillim të vitit 2012. Ky ri-organizim është bërë në një nivel më të gjerë për t'i futur në funksion burimet e nevojshme për jetëgjatësinë e Agjencisë deri sa të kompletohet i tërë procesi i privatizimit dhe mbetet vetëm procesi i likuidimit.

Në mënyrë që të eliminohen tepricat dhe dykuptimësitë e llogaridhënies, një vijë e re e raportimit është themeluar në shërbim të efikasitetit dhe efektshmërisë më të madhe në zbatimin e misionit kyç të Agjencisë.

Tani Agjencia funksionon në dy shtylla kryesore: Divizioni i Shitjes dhe Divizioni i Likuidimit që udhëhiqen nga Zëvendës Drejtorët Menaxhues të AKP-së.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtoresha Menaxhuese e Divizionit të Shitjes dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues i Divizionit të Likuidimit. Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Financave dhe Buxhetit
- Departamenti e Koordinimit Rajonal
- Departamenti i Shitjes
- Departamenti për Koordinim të Likuidimit
- Departamenti Ligjor
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit Publik.

Agjencia gjithashtu e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë. Ka të themeluara pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe tri (3) zyra satelitore (Graçanicë, Shtërpce dhe Leposaviq).

AKTIVITETET E AGJENCISË

Agjencia Kosovare e Privatizimit në portfolion e saj, në fund të vitit 2012 numëron 592 ndërmarrje shoqërore. Gjatë vitit 2012, AKP ka mbajtur tri (3) valë të privatizimit: Vala 54, Vala 55 dhe Vala 56, tetë (8) shitje të aseteve me likuidim (SHAL): SHAL 11, SHAL 12, SHAL 13, SHAL 14, SHAL 15, SHAL 16, SHAL 17 dhe SHAL 18. Veç këtyre, në përputhje me Planin e Punës të AKP-së për vitin 2012 AKP ka realizuar përgatitjen dhe ka mbajtur ditën e shitjes për dy projekte individuale duke

shfrytëzuar menaxhimin alternativ të tenderit për këto ndërmarrje të përzgjedhura e duke u bazuar në potencialin dhe nevojën e tyre për një bashkëveprim më të fokusuar me investitorin, për NSH Hotel Onix Banja e Pejës dhe Fabrika e Baterive Industriale Trepça.

Nga administrimi i AKP-së, që nga fillimi e deri më tani, janë larguar NSH-të në vijim:

1. Kooperativa Bujqësore "Dibra" Skenderaj. (SDR 0084).
2. Institucioni për Menaxhim, Mirëmbajtje, Ndërtim dhe Shfrytëzim të objekteve për aktivitete sportive të qytetit të Prishtinës "MARKETINGSPORT", Prishtinë. (SDR 0118).
3. BVI për banim dhe lokale afariste Pejë. (SDR 0102).
4. Instituti BIOTEKNIK, Pejë. (SDR 057).
5. Kompania Publike Komunale "Trafiku Urban" Prishtinë. (SDR 0727).
6. Kooperativa Bujqësore "Lushtaku", Skenderaj (SDR 0085).

Në përputhje me Ligjin e ri (04/l-034) AKP ka angazhuar konzorciumin Deloitte dhe Tashko&Pustina për projektin "Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës" me ç'rast më 10 korrik 2012 është nënshkruar kontrata në mes të palëve.

Në mbledhjen e mbajtur më 21 qershor 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka marrë vendim për themelimin e Autoriteteve të Likuidimit (AL-ve) të ndërmarrjeve që tanimë janë në likuidim, dhe shuarjen e Komisioneve të Likuidimit (KL-ve). Bazuar në këtë vendim gjatë vitit 2012 është bërë emërimi i Autoriteteve të Likuidimit për 173 NSH në likuidim. Me rastin e emërimit të AL-ve për ndërmarrjet përkatëse janë shuar të gjitha aktivitetet e Komisioneve të Likuidimit më parë të emëruara, dhe të gjitha kompetencat dhe përgjegjësit i janë bartur AL-ve. Gjithashtu është bërë pranimit dorëzimi i këtyre kompetencave nga KL-ja në AL. Qëllimi i angazhimit të Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP) është që të përmbyllë procesin e likuidimit të të gjithë portfolios së Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë nën përgjegjësin apo mandatin e AKP-së. Respektivisht, kontraktori do të kryesoj Autoritetet e Likuidimit të cilat do të themelohen konform dispozitave ligjore të parapara në Ligjin e AKP-së dhe do të jenë përgjegjës për mbledhjen, vlerësimin dhe gjykimin e kërkesave të parashtruara nga kreditorët. Kontraktori poashtu do të ndërmerr secilin veprim ligjor që mund të nevojitet gjatë procesit të likuidimit, propozimin e planit për shpërndarjen e fondeve ndaj kreditorëve të cilëve ju janë aprovuar kërkesat si dhe

trajtimin e të gjitha aspekteve administrative të procesit të likuidimit deri në shpërbërjen zyrtare të NSH-ve pas përmbylljes së procesit të likuidimit. OShP-ja është angazhuar që të luaj rolin e përcaktuar në kuadër të AL-së edhe që të sigurojë një menaxhim efektiv të likuidimit të këtyre ndërmarrjeve, me synim mbylljen përfundimtare të rasteve si dhe mundësin e shpërndarjes së fondeve ndaj kreditorëve të ligjshëm dhe nëse ka fonde tepricë të mbetura pas pagesës së këtyre kreditorëve fondet e mbetura sipas ligjit kthehen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Me përshpejtimin dhe përmbylljen përfundimtare të procesit të likuidimit për të gjitha Ndërmarrjet Shoqërore në Republikën e Kosovës do të ndihmohet procesi i zhvillimit ekonomik të vendit ngase mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimit dhe likuidimit do të funksionalizohen duke i paguar kreditorët e ligjshëm, përderisa mjetet tepricë të këtyre fondeve sipas ligjit do të barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2012, respektivisht me datën 21 qershor 2012 Bordi i AKP-së mori vendimin e rëndësishëm duke miratuar transferimin e shumës prej afro 29 milionë euro në buxhetin e Kosovës nga fondi i mirëbesimit, mjete këto të identifikuar si "fonde tepricë" nga procesi i likuidimit në përputhshmëri me nenin 19.3.3. të Ligjit të AKP-së sipas të cilit AKP-ja i përcakton dhe deklaron si "Fonde Tepricë" deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të çdo të ardhur që e tejkalon maksimumin e vlerës së përlllogaritur të grumbulluar të pretendimeve përkatëse të kreditorit dhe interesave të pohuara të pronësisë, dhe menjëherë i transferon ato Fonde Tepricë në "para publike" që trajtohen në pajtim me LMFPP, të cilat do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës.

Duhet pasur parasysh se moskonstituimi i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për më shumë se gjashtë muaj ka shkaktuar ngërç institucional dhe ka pamundësuar AKP-në që të zbatoj plotësisht mandatin e saj siç është paraparë me ligj. Si rezultat i kësaj kanë mbetur pa u miratuar shumë çështje qenësore që rrjedhimisht përveç ndikimit negativ në funksionimin dhe reflektimin publik të AKP-së kanë shkaktuar konfuzion dhe pakënaqësi edhe tek investitorët, depozitat e të cilëve janë mbajtur në fondet e mirëbesimit të AKP-së. Nga Shitjet e Projekteve Individuale, Valës 56, Shitjes së Aseteve 16, 17&18 shuma totale e dpozitave të mbajtura nga AKP ishte €2,879,000.

Në vijim, shkurtimisht janë të paraqitura çështjet e mbetura peng deri në emërimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së:

- Informimi dhe miratimi i Listave të Punëtorëve të shqyrtuara nga Komisioni për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve.
- Diskutim dhe aprovim për shitjen e koncentratit të Trepçës; Diskutim dhe aprovim lidhur me çështjen e rrogave të punëtorëve të Trepçës; Diskutim dhe aprovim lidhur me përbërjen e Komisionit Përzgjedhës për pozitën e shpallur për Menaxher të Trepçës.
- Diskutim dhe miratim i transaksioneve të Valës 56 të privatizimit. Diskutim dhe miratim i transaksioneve të Shitjes përmes Likuidimit 16. Diskutim dhe miratim i transaksioneve të Shitjes përmes Likuidimit 17. Diskutim dhe miratim i transaksioneve të Shitjes për dy projektet individuale;
 - a) Ndërmarrja e Re Onix Banja e Pejës – Ilixhe Shëndetësore Sh.P.K, dhe
 - b) Ndërmarrja e Re FBI Trepça Sh.P.K.
- Diskutim dhe miratimi i Valës 57 të privatizimit. Informim dhe miratimi i memorandumit për përcaktimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara. Diskutimi dhe miratimi i Valës 58 të privatizimit.
- Diskutimi dhe miratimi i vendimeve të rekomanduara nga Komisioni për Shitjen e Banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore.
- Diskutimi dhe miratimi i Kontratave të Qirasë. Diskutim për propozimet për qiradhënie fillestare të disa pronave të ndërmarrjeve shoqërore. Diskutimi dhe miratimi i memorandumit për largim nga Administrimi i Drejtpërdrejtë i NSH Emin Duraku.
- Diskutimi dhe miratimi i memorandumit për emërimin e Bordit Menaxhues për ndërmarrjet:
 - a) Ndër e Re Hotel Grand Prishtinë;
 - b) Ndër e Re XIM Strezovc;
 - c) Ndër e Re Fapol.
- Informimi dhe miratimi i kërkesave nga ndërmarrjet e Privatizuara me kushte dhe me Spin-off Special.
- Pasqyrat Financiare të Fondeve në Mirëbesim për periudhën e përfunduar më 30 shtator 2012;
- Pasqyrat Financiare të Buxhetit për periudhën e përfunduar më 30 shtator 2012;

DIVIZIONI I SHITJES

Aktivitetet e Divizionit të Shitjes shtrihen në fushën e organizimit të valëve të privatizimit, shitjen e asetëve me likuidim, realizimin e administrimit të drejtpërdrejtë, vendosja nën kontroll dhe mbikëqyrje e ndërmarrjeve të komercializuara apo me kushte si dhe organizimi i publikimeve, marketingut dhe vendosja e marrëdhënieve të mira me investitorë. Rrjedhimisht Departamenti i Shitjes, Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë, Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje si dhe Njësia për Marrëdhënie me Investitorë i raportojnë drejtpërdrejtë Zëvendës Drejtoreshës Menaxhuese të AKP-së e cila është përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë.

DEPARTAMENTI I SHITJES

Me ristrukturimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit Departamenti i Shitjes ka pësuar ndryshime të dukshme dhe tani i tërë procesi i shitjes që nga përgatitja e shitjes, realizimi i shitjes e deri te kontrata e shitjes është koncentruar në këtë Departament. Departamenti i Shitjes përbëhet nga Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes, Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes dhe Njësia e Kadastrit. Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e Privatizimit dhe Shitjes së Asetëve të NSH-ve përmes Likuidimit.

SHITJET PËRMES SPINOF-IT

PRIVATIZIMI

Nr.	Valët e Privatizimit	Ndërmarrjet e Reja të ofruara për privatizim	Ndërmarrjet e Reja pa oferta	Ndërmarrjet e Reja të anuluar	Ndërmarrjet e Reja të aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1	54	29	10	7	12	€ 1,546,174
2	55	23	6	1	16	€ 8,217,213
3	56	34	8	9	17	€10,627,097

Kontrata të nënshkruara të privatizimit në vitin 2012	Totali
64	€ 21,071,336.00

* Mospërputhja e totaleve të të hyrave në mes të shitjes së asetëve dhe kontratave të nënshkruara, është për shkak se në vitin 2012 në tabelën e kontratave të nënshkruara janë të përfshira ratifikimet e kontratave të mbetura nga viti/vitet paraprake si dhe kontratat për Shitjen e Asetëve 16, 17 dhe 18 nuk janë të përfshira për shkak të mungesës së Bordit të AKP-së.

LIKUIDIMI

Nr.	Shitja e Aseteve	Asetet e ofruara për privatizim	Asetet pa oferta	Asetet e anuluar	Asetet e aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1	11	29	7	4	14	€903,948
2	12	22	4	5	13	€1,839,426
3	13	23	12	3	8	€1,773,192
4	14	18	4	1	13	€3,891,187
5	15	34	11	4	19	€3,502,412
6	16	36	18	1	17	€1,476,146
7	17	62	25	8	29	€4,767,137
8	18	49	19	6	24	€2,956,763
		269	100	32	137	€ 21,110,211

Kontrata të nënshkruara të likuidimit në vitin 2012	Totali
98	€ 19,505,120.00

* Mospërputhja e totaleve të të hyrave në mes të shitjes së asetëve dhe kontratave të nënshkruara është për shkak se në vitin 2012 në tabelën e kontratave të nënshkruara janë të përfshira ratifikimet e kontratave të mbetura nga viti/vitet paraprake si dhe kontratat për Shitjen e Aseteve 16, 17 dhe 18 nuk janë të përfshira për shkak të mungesës së Bordit të AKP-së.

PROJEKTET INDIVIDUALE

Dita e Ofertimit të Projekteve Individuale është mbajtur më datë 20 korrik 2012, e cila përbëhej nga Ndërmarrja e Re Hotel Onix Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore SH.P.K. dhe Ndërmarrja e Re FBI Trepça SH.P.K. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar ishte 3, me shumë totale të ofertave fituese prej € 8,135,000.

Për Ndërmarrjen e Re Hotel Onix Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore SH.P.K. u pranua vetëm një ofertë ndërsa për Ndërmarrjen e Re FBI Trepça SH.P.K. u pranuan dy oferta.

Nr.	Projektet Individuale	Ndërmarrjet e Reja të ofruara për privatizim	Ndërmarrjet e Reja pa oferta	Ndërmarrjet e Reja të anuluar	Ndërmarrjet e Reja të aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1.	Hotel Onix Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore Sh.P.K	1	0	0	1	€6,100,000
2.	FBI Trepça Sh.P.K.	1	0	0	1	€2,035,000
	Totali	2	0	0	2	€ 8,135,000

* Ratifikimi i kontratave të shitblerjes së Projekteve Individuale do të realizohet në vitin 2013.

SHITJET PËRMES SPINOF-IT

Shitja e Valës 54

Dita e ofertimit të shitjes së Valës 54 përmes Privatizimit është mbajtur më datë 29 mars 2012, e cila përbëhej nga njëzet e nëntë (29) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për këtë shitje ishte 49, me shumë totale të ofertave fituese prej €1,755,957. Për dhjetë Ndërmarrje të Reja (10) të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për nëntë (9) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për dhjetë (10) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Ofertat për Dymbëdhjetë Njësi janë anuluar për shkak të mosplotësimit të të gjitha fushave të ofertës dhe mungesës së dokumentacionit të përcaktuar sipas Rregullave të Tenderit.

Shitja e Valës 55

Dita e ofertimit të shitjes së Valës 55 përmes Privatizimit është mbajtur më datë 30 maj 2012, e cila përbëhej nga njëzet e tri (23) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për këtë shitje ishte 65, me shumë totale të ofertave fituese prej €8,344,213.

Për trembëdhjetë Ndërmarrje të Reja (13) të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për katër (4) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për gjashtë (6) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Shitja e Valës 56

Dita e ofertimit të shitjes së Valës 56 përmes Privatizimit është mbajtur më datë 19 shtator 2012, e cila përbëhej nga tridhjetë e katër (34) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për këtë shitje ishte 137, me shumë totale të ofertave fituese prej €14,006,426. Për njëzet Ndërmarrje të Reja (20) të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, gjashtë (6) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për tetë (8) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes ka pasur 3 anulime të ofertave. Në vazhdim të përpjekjeve të Divizionit të Shitjes për të ngritur vetëdijen e ofertuesve në aspektin administrativ janë ndërmarrë hapa konkret për të shmangur anulimin e ofertave për shkak të gabimeve në plotësimin e dokumentacionit për ofertim. Janë vendosur shpallje të dimensioneve 1.5 metra me 1.5 metra para vendit të ofertimit dhe për çdo ditë të shitjes janë vënë në dispozicion nga tre zyrtarë të AKP-së të cilët kanë asistuar investitorët lidhur me plotësimin e dokumentacionit. Për më tepër është shfaqur edhe një reklamë televizive me udhëzime konkrete në këtë aspekt.

SHITJA E ASETEVE TË

NDËRMARRJEVE SHOQËRORE NË LIKUIDIM

Shitja përmes Likuidimit 11

Dita e ofertimit të shitjes 11-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 29 shkurt 2012, e cila përbëhej nga njëzet e pesë (25) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 55, me shumë totale të ofertave fituese prej €1,108,958.

Për dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për gjashtë (6) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për shtatë (7) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Shitja përmes Likuidimit 12

Dita e ofertimit të shitjes 12-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 29 mars 2012, e cila përbëhej nga njëzet e dy (22) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 67, me shumë totale të ofertave fituese prej €1,942,764.

Për njëmbëdhjetë (11) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për gjashtë (6) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për pesë (5) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Shitja përmes Likuidimit 13

Dita e ofertimit të shitjes 13-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 26 prill 2012, e cila përbëhej nga njëzet e tri (23) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 22, me shumë totale të ofertave fituese prej €2,033,414.

Për katër (4) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për shtatë (7) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Shitja përmes Likuidimit 14

Dita e ofertimit të shitjes 14-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 30 maj 2012, e cila përbëhej nga tetëmbëdhjetë (18) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 51, me shumë totale të ofertave fituese prej €3,891,187.

Për nëntë (9) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për pesë (5) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për katër (4) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 4 anulime të ofertave.

Shitja përmes Likuidimit 15

Dita e ofertimit të shitjes 15-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 27 qershor 2012, e cila përbëhej nga tridhjetekatër (34) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitjen përmes Likuidimit ishte shtatëdhjetë e katër (74), me shumë totale të ofertave fituese prej € 2,646,559.

Për 12 dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për njëmbëdhjetë (11) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëmbëdhjetë (11) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, përderisa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 5 anulime të ofertave.

Shitja përmes Likuidimit 16

Dita e ofertimit të shitjes 16-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 19 shtator 2012, e cila përbëhej nga tridhjetë e gjashtë (36) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 84, me shumë totale të ofertave fituese prej €2,676,146.

Për dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për gjashtë (6) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për tetëmbëdhjetë (18) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve nuk ka pasur anulime të ofertave.

Shitja përmes Likuidimit 17

Dita e ofertimit të shitjes 17-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 17 tetor 2012, e cila përbëhej nga gjashtëdhjetë e dy (62) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 104, me shumë totale të ofertave fituese prej €5,563,768.

Për nëntëmbëdhjetë (19) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për tetëmbëdhjetë (18) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëzet e pesë (25) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 1 anulim të ofertës.

Shitja përmes Likuidimit 18

Dita e ofertimit të shitjes 18-të përmes Likuidimit është mbajtur më datë 05 dhjetor 2012, e cila përbëhej nga katërdhjetë e nëntë (49) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Shitje përmes Likuidimit ishte 73, me shumë totale të ofertave fituese prej €3,003,813.

Për dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për shtatëmbëdhjetë (17) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëzet (20) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 2 anulime të ofertës.

KONTRATAT

Nënshkrimi i kontratave me blerësit:

Gjatë vitit 2012 deri më 31 dhjetor janë nënshkruar dhe dorëzuar te blerësit gjithsej 162 kontrata, prej tyre 64 privatizim dhe 98 me likuidim.

Të gjitha kontratat e papërfunduara:

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME

Për pesë (5) shitje kemi ndalesa nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen:

1. Ndër. e Re "Farmakos Blue Factory Sh.P.K." - Vala 2
2. Ndër. e Re "AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K." - Vala 37
3. Ndër. e Re "KB Shtime Zyra Administrative Sh.P.K." – Vala 42
4. Ndër. e Re "Punëtorja Iliria Sh.P.K." – Vala 43
5. Ndër. e Re "Tokë Bujqësore në Tërstenik Sh.P.K." – Vala 51.

LISTAT E NDËRMARRJEVE NË ADMINISTRIM TË DREJTËPËRDREJTË

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i ndërmarrjeve është bërë nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSH kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit, e që reflektonte në dëm të interesave të NSH-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSH-në e cila shfaq një trend rënie atëherë propozohen masat e Administrimit të Drejtëpërdrejtë nga Zyrat Rajonale të AKP-së për tu implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSH-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara veçanërisht nga Bordi i Drejtorëve.

Në bazë të ligjit të miratuar në shtator të vitit 2011, ligji nr. 04/L-034 neni 6.1, Njësia e Administrimit të Drejtëpërdrejtë të AKP-së është përgjegjëse për të kontrolluar dhe administruar me Ndërmarrjet të vendosura nën Administrimin e Drejtëpërdrejtë të AKP-së.

Ndërmarrjet e tërhequra nga Administrimi i Drejtëpërdrejtë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012

Nr. i NSh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
1.	<p>NSH "Sharr-Prodhimi" Dragash</p>	<p>Ndërmarrja është vendosur nën AD me 30 nëntor 2011. Kjo ndërmarrje ka pasur kryesisht probleme pronësore me KK Dragash, për shkak të tjetërsimit të 29.727 ha tokë nga ana e Komunës në mënyrë kundërligjore.</p>	<p>AD ka arritur që të rrisë të hyrat duke vizituar të gjitha asetet nëpër fshatra, duke biseduar me qiraxhinjtë /uzurpatorët e atëhershëm, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin ka arritur të hartojë kontrata të reja të qirasë për shfrytëzimin e tokave të kësaj NSH-je. Stafit është paguar në baza mujore kryesisht nga të hyrat vetanake (qiratë) që kanë arritur shumën totale mujore 1300-1500 euro. Në vazhdimësi është përcjellë edhe gjendja e rreth 260 fryme dele që gjatë dimrit kanë qenë nëpër stalla.</p> <p>Gjendja e përgjithshme financiare dhe menaxhuese në NSH është stabilizuar, ndërsa problemi kryesorë i kësaj ndërmarrje vazhdon të jetë tjetërsimi i pronës nga ana e KK të Dragashit. Duke u nisur nga fakti se pjesa më e madhe e pronës është e përfshirë në projektligjin për park nacional AD ka propozuar që kjo NSH të largohet nga Administrimi i drejtëpërdrejtë dhe të vendoset nën Administrimin e ZR të Prizrenit. Kjo NSH është larguar nga AD me vendimin e Bordit të Drejtorëve në muajin qershor 2012.</p>	<p>Asetet e mbetura të Ndërmarrjes të cilat nuk janë të përfshira në parkun nacional do të përgatiten për privatizim nga ZR e Prizrenit</p>

Ndërmarrjet e vëna nën Administrim të Drejtëpërdrejtë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012



Nr. i Nsh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
2.	<p>Ndërmarrja e Re Miniera "XIM Strezovc" Kamenicë</p>	<p>Pas vendimit të Bordit të drejtorëve për tërheqjen e aksioneve, kjo Ndërmarrje është futur nën AD me 20/07/2012. Gjatë vizitës në Ndërmarrje është vërejtur se pothuajse të gjitha asetet/mjetet themelore janë asgjësuar nga ish-blerësi.</p>	<p>-Administrimi i Drejtëpërdrejtë ka vizituar gurthyesin dhe minierën në Strezovc. Gurthyesi ishte në gjendje relativisht të mirë dhe me disa intervenime të vogla do të mund të aktivizohet. Nga kjo vizitë kemi konstatuar një potencial shumë të madh me të cilin disponon kjo NR. Nga ana e punëtorëve të NR-së, jemi njoftuar se ekzistojnë disa kompani Gjermane dhe Austriake të cilat kanë shprehë interesim për këtë minierë, e në veçanti për shfrytëzimin e Magneziumit. Është konstatuar se ky lloj i Magneziumit është shumë i pastër, dhe ka vlerë shumë të madhe, pasi që kostoja e përpunimit të tij, respektivisht përzjerjes do të jetë shumë më e vogël.</p>	<p>Kjo ndërmarrje është paraparë që të lansohet për privatizim gjatë vitit 2013.</p>

Nr. i NSh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit Direkt	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
3.	<p>Ndërmarrja e Re “Grand Hotel Prishtina”</p>	<p>Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve për tërheqjen e aksioneve, kjo Ndërmarrje është vendosur nën AD me 20/07/2012. Gjendja financiare e kësaj Ndërmarrje ka qenë shumë e vështirë. Në këtë ndërmarrje ka pasur edhe probleme me çasje në ujësjellës pasi që kjo Ndërmarrje ka qenë e shkyqyr nga ujësjellësi, dhe ngrohtarja.</p> <p>Po ashtu kjo ndërmarrje ka probleme edhe ligjore, pasi që Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme ka aprovuar kërkesën e ish blerësit për masë të përkohshme që të ndalohet transferimi i aksioneve.</p>	<p>Administrimi i Drejtëpërdrejtë, ka arritur të aktivizoj qasjen në ujësjellës, linja telefonike dhe në Internet (wireless)</p> <p>Ka arritur të nënshkruaj marrëveshje për riprogramim të borxheve me Ndërmarrje publike, KEK, PTK, TERMOKOS etj.</p> <p>Ka arritur që të shpërndajë pagat e punëtorëve të cilët nuk kishin marrë 8 pagat e fundit nga ana e ish Blerësit të kësaj Ndërmarrjeje</p> <p>Ka arritur lëshimin me qira të disa aseteve (parkingu, zyre, lokale afariste dhe hapësira reklamuese) nga te cilat paguhen pagat e punëtorëve dhe shpenzimet tjera të Ndërmarrjes. AD po bën përpjekje për të kthyer imazhin e hotelit përmes njoftimeve, promovimeve të çmimeve të reja dhe mënyrave tjera të marketingut. Në vijim do të paraqesim të dhënat financiare gjatë periudhës së Administrimit të kësaj Ndërmarrje:</p> <p>Te hyrat e pergjithshme: 109,025 euro Shpenzimet: 132,841 euro</p>	<p>Pas vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për vendosjen e masës së përkohshme me të cilën ndalohet AKP-ja që të bëjë transferimin e aksioneve të Ndërmarrjes së re “Hotel Grand Prishtina” tek ndonjë palë e tretë, AKP do të pres që kjo masë e përkohshme të largohet dhe Ndërmarrja të lahsohet për shitje.</p>

Ndërmarrjet të cilat janë Administruar nga AD gjatë vitit 2012 të trashëguara nga vitet paraqra

Nr. i NSh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
4.	<p>NSH "ERENIKU INDUSTRIA" GJAKOVË</p>	<p>-Kontrolli mbi mirëmbajtjen dhe ruajtjen e rezervave të verës dhe destilatit e verës të cilat kanë qenë objekt i keqpërdorimeve; Pjesë e kësaj ndërmarrjeje, përkatësisht bodrumi i verës ishte futur në privatizim në valën 50, dhe si rezultat i vendimit për caktimin e masës së përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supresme, është tërhequr nga Privatizimi, deri në vendimin e ardhshëm të Gjykatës lidhur me statusin e ndërmarrjes</p>	<p>-Masat e menjëhershme të ndërmarrja pas vendosjes së ndërmarrjes nën kontrollin e Njesisë së AD janë si në vijim: a) Suspendimi i Manaxhmentit të Ndërmarrjes; b) Inspektimi i hapësirës së Ndërmarrjes; c) Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe bllokimi i xhirlogarive bankare të Ndërmarrjes; d) Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitetet e kontraktuara; e) Ndalimi i qasjes në dokumente të ndjeshme; ë) Regjistrimi i aseteve të Ndërmarrjes; f) Emërimi i Bordit të përkohshëm Menaxhues; g) Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me rregulloret e punës së AKP-së. Administrimi i drejtpërdrejt i Ndërmarrjes ka arritur rezultate të mira duke përmirësuar gjendjen e ndërmarrjes sidomos në aspektin e të hyrave. Është arritur një rritje e inkasimit të qirave, me ç'rast edhe pakënaqësia e punëtorëve u amortizua, pasi që tani NSH-ja posedon mjete të mjaftueshme për paga të punëtorëve aktiv. "Fabrika e lëngjeve" është privatizuar në valën e 51-të dhe pasi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e ka tërhequr masën e përkohshme është finalizuar kontrata e shitjes me blerësin. -Është kërkuar nga Ministria e Bujqësisë që të bëjë analizat e verës dhe të bëjë një përkufizim të produktit me qëllim zhbllokimin e shitjes së verës. Pas analizave kjo Ministri ka përcaktuar se vera mund të shitet vetëm si destilat i verës dhe një pjesë si uthull. Po ashtu gjatë kësaj periudhe të administrimit të kësaj Ndërmarrjeje janë kthyer në posedim të Ndërmarrjes asete të cilat janë shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme nga uzurpues të ndryshëm.</p>	<p>Pas aprovimit nga ana e Bordit të AKP-së do të fillojmë me përgatitjet dhe procedurat e shitjes së Verës (destilatit, uthullës,) sipas rekomandimeve të Ministrisë së Bujqësisë. Pas heqjes së masës së përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme do të përgatiten për privatizim edhe njësitë tjera të Ndërmarrjes</p>

Nr. i NSH	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vëzhgimet e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
5.	<p>NSH "Enti për Terapi Fizikale dhe Rehabilitim" Banjë afër Pejës"</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Borxhi ndaj ATK-së në vlerë prej 900.000 euro, - Mungesat e rregulloreve të brendshme, - Problemet e shumta me keqpërdorime nga zyrtarët e NSH-së -Uzurpime dhe shkatërrime të pronës shoqërore nga personat privat. 	<p>-Pas futjes së Ndërmarrjes Shoqërore nën kontrollin e Njësisë së Administrimit të Drejtëpërdrejtë, duke u mbështetur në ligjin e AKP-së dhe politikat operacionale, me qëllim të rritjes së vlerës dhe menaxhimit më të mirë të ndërmarrjes, u ndërmorën masat e menjëhershme si në vijim: a) Suspendimi i Manaxhmentit të Ndërmarrjes b) Inspektimi i hapësirës së Ndërmarrjes c) Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe bllokimi i xhirologarive bankare të Ndërmarrjes d) Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitetet e kontraktuara e) Ndalimi i qasjes në 'dokumente të ndjeshme' ë) Regjistrimi i asetëve të Ndërmarrjes f) Emërimi i Bordit të përkohshëm Menaxhues g) Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me rregulloret e punës së AKP-së.</p> <p>-Pas inspektimit të Ndërmarrjes është konstatuar se në NSH nuk zbatohet, e as që ekziston ndonjë rregullore e brendshme për punë. Duke konstatuar gjendjen alarmante në Ndërmarrje, Njësia e AD ka ndërmarrë hapat e menjëhershëm për të implementuar rregulloret e brendshme të punës në Ndërmarrje, të cilat janë konsideruar si të domosdoshme për mbarevajtjen më të mirë të punës, dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjes Shoqërore. Rregulloret të cilat janë hartuar, dhe janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, kanë filluar të implementohen dhe kanë sjellë rezultat pozitiv në mbarevajtjen e punëve në këtë Nsh.</p> <p>Njësia e Administrimit të Drejtëpërdrejtë ka qenë pjesë e përgatitjes së kësaj Ndërmarrjeje për privatizim ku është privatizuar por pritet që të bëhet aprovimi nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.</p>	<p>Në varësi nga vendimi i Bordit të AKP-së lidhur me miratimin apo mos miratimin e shitjes së kësaj ndërmarrjeje, do ndërmerren veprime të mëtutjeshme për ruajtjen e vlerës së ndërmarrjes.</p>



Nr. i NSH	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështrësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
6.	NSH” Boksitet e Kosovës”	Ndërmarrja ka hyrë në AD në fillim të vitit 2012 (20 janar 2012); ka pasur probleme të mëdha rreth arkëtimit të borxheve nga qiratë e aseteve; obligime ndaj ATK, KEK dhe paga të papaguara të punëtorëve etj.	<p>Pas futjes së Ndërmarrjes Shoqërore nën kontrollin e Njësisë së Administrimit të Drejtëpërdrejtë, duke u mbështetur në ligjin e AKP-së dhe politikat operationale, me qëllim të rritjes së vlerës dhe menaxhimit më të mirë të ndërmarrjes, u ndërmorën masat e menjëhershme si në vijim: a) Suspendimi i Manaxhmentit të Ndërmarrjes b) Inspektimi i hapësirës së Ndërmarrjes c) Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe xhirologarive bankare të Ndërmarrjes d) Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitetet e kontraktuara e) Ndalimi i qasjes në 'dokumente të ndjeshme' ë) Regjistrimi i aseteve të Ndërmarrjes f) Emërimi i Bordit të përkohshëm Menaxhues g) Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me rregulloret e punës së AKP-së.</p> <p>Gjatë periudhës nën AD, pas konstituimit të Bordit të përkohshëm Menaxhues, në bashkëpunim me zyrtarët e Administrimit të Drejtëpërdrejtë të AKP-së, ndërmarrja ka arritur të hyrat e saj kryesishat nga arkëtimi i borxheve nga dy qiraxhinjtë kryesor, të dy qiraxhinjtë i kanë kryer obligimet e veta; ndërkohë, menaxhmenti i ndërmarrjes ka bërë kërkesë për lëshimin me qira të seperacionit / gurëthyesit dhe pas tri shpalljeve të njëpasnjëshme ka arritur të përzgjidhet OE i përgjegjshëm dhe është nënshkruar kontrata. Në këtë mënyrë ndërmarrja po vazhdon të kryej obligimet e saj ndaj ATK-së (sipas riprogramimit të borxhit), ka përmirësuar bilancin e të hyrave dhe po paguan paga për një numër të stafit të angazhuar. Prej këtij muaji edhe anëtarët e bordit do të financohen nga të hyrat e ndërmarrjes, po ashtu përmes këtyre mjeteve janë paguar të gjitha obligimet për marrjen e licencës prej KPMIM. Për momentin Ndërmarrja i ka rreth 60.000 euro në llogarinë bankare. Në vitin që po e lëmë pas kemi aplikuar për mbajtjen e licencës së Hulumtimit për Boksitet në KPMIM e cila kërkesë është aprovuar edhe për një vit.</p>	Në të ardhmen planifikohet që të lëshohet me qira Fabrika e Ilaçit pasi që ka skaduar kontrata qirasë ekzistuese. Po ashtu gjatë vitit 2013, AKP planifikon që të vendos këtë NSH në një nga valët e privatizimit.

Nr. i Nsh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
7.	NSH "Emin Duraku"	<p>-Vështirësi në inkasimin e qirasë.</p> <p>-Tentimet për vjedhje;</p> <p>-Kërcënimet e vazhdueshme që i bëhen Manaxhmentit nga i ashtuquajtimi Kuvendi i Aksionarëve;</p>	<p>-Situata në NSH Emin Duraku mbahet nën kontroll me kompaninë e sigurimit të kontraktuar nga AKP-ja;</p> <p>-Është përmirësuar dukshëm mbledhja e qirasë dhe nga kjo paguhet menaxhmenti, stafi dhe punëtorët e asistencës sociale.</p> <p>-Së bashku me Zyrën Regjionale të AKP-së në Pejë janë përgatitur për privatizim tri asete të kësaj ndërmarrjeje dhe të tria janë shitur. Për këto tri asete ka pasur masë të Përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Pasi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka sjellë Aktvendim me të cilin ka tërhequr masën e përkohshme të kësaj Ndërmarrjeje kemi bërë finalizimin e shitjes së kësaj Ndërmarrjeje tek blerësit e ri.</p>	<p>-Pas heqjes së Masës së Përkohshme, nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së është aprovuar shitja e kësaj ndërmarrjeje dhe është finalizuar kontrata e shitjes me blerësit e ri.</p> <p>NUAD ka përgatitur një Memorandum për Bordin e AKP-së që kjo Ndërmarrje të hiqet nga Administrimi i Drejtëpërdrejtë.</p>



Nr. i NSH	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
8.	NSH "ARTIZANATI"	<ul style="list-style-type: none">- Ndërmarrja nuk operon me biznesin e vet thelbësor dhe të hyrat i ka nga dhënia me qira e ndërtesave në Prishtinë.-Ekziston mungesë e dokumentacionit në lidhje me të drejtat e posedimit të ndërmarrjes.- 20 vitet e fundit menaxhmenti ka dështuar të dokumentojë posedimin e ndërmarrjes.	<ul style="list-style-type: none">- Me 31 qershor 2006, ndërtesa i është dhënë me qira Ministrisë së Punëve të Brendshme për një periudhë dy vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit në shumë prej 3,000.00 € për muaj, plus TVSH-ja.- Nga kjo qira paguhen 16 punëtorët e ndërmarrjes- Në vitin 2011 nuk ka pasur ndonjë aktivitet të theksuar në këtë ndërmarrje.	<ul style="list-style-type: none">- Identifikimi i të drejtave të posedimit dhe përgatitja për procesin e privatizimit.- Do të bëhet përpjekje që kjo ndërmarrje të privatizohet gjatë vitit 2013.

Nr. i NSH	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
9.	<p>- Ndërmarrja i ka lënë hipotekë disa asete të saj Institucionit Financiar ABU në emër të kredisë në vlerë prej 1.1 milion €. Hipoteka aplikohet ndaj të gjitha aseteve të ndërmarrjes përveç ndërtesës së Administratës, përfshirë këtu edhe pasurinë e patundshme, e cila edhe është aseti kryesor i saj.</p> <p>-problem paraqet përpjekjet e vazhdueshme të ndërmarrësve privat për eksplotim të zhavorrit nga hapësirat e ndërmarrjes.</p> <p>NSH "Unimont"</p>	<p>-Janë caktuar dy persona përgjegjës nga kjo ndërmarrje të cilët i raportojnë AKP-së.</p> <p>-Qiramarrësi e ka lëshuar ndërmarrjen me marrëveshje me AKP-në.</p> <p>-Është arritur që pas tenderimit të dytë të shitet një aset i kësaj ndërmarrje "Ndërtesa e Administratës"</p> <p>-Në dy asetet e tjera të kësaj ndërmarrje "Baza e asfaltit" dhe "Baza e betonit" kemi angazhuar kompaninë e sigurimit për të ruajtur asetet.</p>	<p>Të ndjekin procedurat gjyqësore dhe të gjendet një zgjidhje lidhur me asetet e hipotekuara si dhe kredinë e papaguar.</p> <p>-Do të bëhet përpjekje që të bëhet azhurnimi i të dhënave në Kadastrën e Prizrenit e më pas të privatizohet asetet kryesore të kësaj NSH-je.</p>	



Nr. i NSH	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
10.	NSH “Qendra për Rini dhe Sport” Pallati i Rinise”	<p>-Problemi më i madh i kësaj ndërmarrje është Vendimi i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme e 15 paditësve që pretendojnë se kishin pësuar me rastin e djegies së një pjese të Pallatit.</p> <p>- Gjatë këtij viti Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka nxjerr vendim me të cilin ka aprovuar padinë e paditësve duke detyruar Pallatin e Rinisë të kompensoj dëmin në vlerë prej rreth 3.3 milioneuro. Ndërmarrja dhe AKP-ja kanë parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata Supreme.</p> <p>-Problem tjetër është edhe mosdefinimi i statusit të kësaj ndërmarrje.</p> <p>-Vjetërsimi i objektit dhe nevojave për riparime të vazhdueshme.</p>	<p>-Trendi pozitiv i afarizimit nga viti i kaluar ka vazhduar edhe këtë vit.</p> <p>- Ndërmarrja ka arritur ti shlyej të gjitha obligimet dhe tani është parapaguese e shërbimeve komunale dhe e tatimeve.</p> <p>- Të hyrat e Ndërmarrjes janë kryesisht nga qiraja, aktivitetet kulturore, aktivitetet ekonomike (reklammat), nga parkingu dhe nga panairret.</p> <p>- Është bërë kufizimi i shpenzimeve.</p> <p>-Është mbajtur numër shumë i madh i shfaqjeve, programeve, manifestimeve dhe aktiviteteve tjera.</p> <p>- Janë riparuar toaletet, zveshtoret e sportistëve si dhe disa hapësira tjera, me ç'rast janë krijuar kushte më të mira për ushtrimin e aktiviteteve të sportistëve, si dhe të shfrytëzuesve të shërbimeve të Ndërmarrjes.</p>	<p>-Kontrollimi dhe monitorimi i llogarisë bankare;</p> <p>-Do të punohet në mbrojtjen ligjore të Pallatit në Gjykatën Supreme, kundër vendimit të Dhomës së Posaçme;</p> <p>- Do të vazhdohet me planin investiv të ndërmarrjes;</p> <p>-Do të punohet në definimin e statusit të Pallatit.</p>

Nr. i NSh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vëzhgimet dhe ndërmarrjet shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
11.	<p>NSH “Dlb-Drejtoria, Lavërtaria dhe Blegtoria”</p>	<p>-Ndërmarrja ka një sipërfaqe afërsisht 2,000 ha që nuk është e regjistruar në emrin e ndërmarrjes por në emrin e ish kombinatit KBI Progres. Ndërmarrja pretendon të jetë trashëgimtarja ligjore e këtij kombinati. Çështja e kadastrës është e lidhur me historikun e kombinatit dhe mënyrën se si toka është marrë nëpërmjet konfiskimit dhe zaptimit të tokës private bujqësore në regjion.</p> <p>Që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999, ndërmarrja ballafaqohet me një numër të madh të ankesave dhe vendimeve gjyqësore në lidhje me tokën e konfiskuar/zaptuar.</p> <p>- Tatimet e papaguara për një kohë të gjatë.</p> <p>- Mungesa e regjistrimit të saktë për pronat e ndërmarrjes.</p> <p>-Mungesat e dokumenteve kadastrale në komunën e Prizrenit.</p>	<p>- Është mbajtur dhe po mbahet numër i madh i proceseve gjyqësore lidhur me kontestet pronësore. Gjatë vitit 2012 janë privatizuar disa asete të rëndësishme të kësaj Ndërmarrje, siç janë objekte dhe toka bujqësore.</p>	<p>- Gjatë vitit 2013 do të privatizohen shumica e aseteve të mbetura të kësaj NSh-je</p>



Nr. i NSh	Emri i ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit të Drejtëpërdrejtë	Vështirësitë e ndërmarrjes shoqërore	Çështje të menaxhimit dhe Qeverisjes Korporative	Perspektiva e së ardhmes
12.	NSH “Vreshtaria” Landovicë	<p>-Për shkak të mungesës së burimeve financiare, vreshtat prej afërsisht 1000 hektarëve nuk janë mirëmbajtur.</p> <p>-Problem paraqesin edhe Paditë e shumta të personave fizik për kthimin e pronave.</p> <p>-Po ashtu problem paraqet edhe fakti se autostrada Vërmicë-Merdare përshkon një pjesë të madhe të tokave të kësaj ndërmarrje, me ç'rast shumë sipërfaqe të rëndësishme janë ndarë në dysh nga autostrada.</p> <p>-Uzurpimet e shumta nga personat fizik.</p>	<p>-Rojet e ndërmarrjes aktualisht janë në vend për të mbrojtur vreshtat nga shkatërrimi dhe vjedhja e shtyllave të betonit ose pasurive të tjera të luajtshme.</p> <p>-17 punëtorë të kësaj ndërmarrje paguhen nga shumta e dhënë nga qeveria, që është 1,895.25 € për muaj.</p> <p>-Në mënyrë që të mbrohen asetet nga dëmtimi/prishja dhe të ofrojnë një mbrojtje të përhershme të vreshtave nga cilado palë e dëmshme, Administrimi i Drejtëpërdrejtë i AKP-së ka angazhuar 16 roje të NSH-së dhe koordinatorin e Ndërmarrjes i cili në të njëjtën kohë do të përgatisë listën e aseteve të kërkuara nga Njësia e Administrimit të Drejtëpërdrejtë të AKP-së. Shtatëmbëdhjetë punëtorë të kësaj ndërmarrje paguhen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Gjatë vitit 2012 janë privatizuar disa sipërfaqe tokësore.</p>	<p>-Qëllimi kryesor është që të mbrohen asetet nga dëmtimi dhe të ofrojnë një mbrojtje të vreshtave nga ndonjë palë e pandërgjegjshme.</p> <p>- Gjatë vitit 2013 Asetet të cilat nuk kanë probleme ligjore do të privatizohen.</p>

NJËSIA PËR KONTROLL DHE MBIKËQYRJE

Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2012 ka përcaktuar prioritetet e veta që kanë qenë si në vijim:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSh-ve të kryera nga zyrtarët tanë për kontroll dhe mbikëqyrje në rajon dhe koordinimin e aktiviteteve me zyrtarët për objektivat e përbashkëta, vizitat në zyrat rajonale dhe NSh-të me qëllim të verifikimit të informatave lidhur me pronën e këtyre ndërmarrjeve, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës, si dhe identifikimin e rasteve ku keqmenaxhimi i kësaj prone mund të ndodhë.
- Transferimi i detyrimeve të NSh-ve tek blerësit që i përkasin 12 muajve të fundit ose 3 muajve të fundit në varësi nga lloji i obligimeve që transferohen.
- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë me institucionet tjera të interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë përkatëse përbrenda Divizionit të Shitjes dhe departamenteve tjera brenda AKP-së. Aktivitete tjera të veçanta lidhur me arritjen e objektivave të Departamentit dhe Agjencisë në tërësi.

Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje bën edhe monitorimin e ndërmarrjeve të komercializuara, ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special dhe ndërmarrjeve të privatizuara me kushte.

Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet që janë nën monitorim të NJKM.

NDËRMARRJET E KOMERCIALIZUARA

Gjatë periudhës raportuese 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012, nën mbikëqyrjen e Njesisë për kontroll dhe mbikëqyrje ka qenë 1 (një) Ndërmarrje e Komercializuar nga 18 (tetëmbëdhjetë) të tilla sa kanë qenë që nga data 13 qershor 2000 kur është bërë edhe Komercializimi i parë në Kosovë. Prej 18 ndërmarrjeve të komercializuara deri më tani janë privatizuar 13 ndërmarrje, një ndërmarrje është në likuidim kurse 4 ndërmarrje janë në pritje të privatizimit. Ndërmarrjet që janë në pritje të privatizimit mbikëqyren nga ana e zyreve regjionale prej nga është Ndërmarrja.

Tabela e ndërmarrjeve të komercializuara gjatë periudhës 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012:

Nr.	Emri i NSh-së	Qiramarrësi	Statusi
1	Fapol	CRK	Nën monitorim - Zgjatje e afatit deri më 30.06.2012

Pas skadimit të afatit të kontratës së komercializimit NSH "Fapol" është kthyer nën menaxhimin e agjencisë Kosovare të Privatizimit – respektivisht Zyrës Regjionale të Prishtinës me qëllim që ndërmarrja të përgatitet për privatizim. Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje ka përgatitur një memorandum informimi lidhur me këtë ndërmarrje i cili do ti prezantohet Bordit të Drejtorëve në takimin e radhës.

SPIN OFF-ET SPECIALE

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore është bërë përmes dy formave: Shitja me Spin Off të thjeshtë ku shitja e ndërmarrjeve të reja është bërë pa kushte të veçanta dhe forma e dytë e shitjes me Spin Off Special. Tek shitja me Spin Off Special blerësit marrin përsipër se gjatë periudhës së paraparë me kushte të kontratës do të bëjnë investime kapitale dhe do të punësojnë një numër të caktuar të punëtorëve varësisht nga kontrata dhe zotimet që marrin me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve të reja. Që nga fillimi i procesit të privatizimit në Kosovë e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së Spin Off-it Special. Në anën tjetër 9 Spin Off-e Speciale gjatë periudhës kohore 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012 kanë vazhduar të jenë aktive, respektivisht në proces të përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Më poshtë janë të listuara NSh-të e privatizuara përmes metodës së Spin Off-it Special të cilat kanë mbetur nën procesin e monitorimit gjatë periudhës 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012:

- Hotel Iliria
- IDGJ Tobacco
- FAN
- Hotel Grand
- NBI Suhareka (Agrokosova Holding)
- MIM Golesh
- XIM Strezovc
- Minex
- Jugoterm

Njësia e Monitorimit, ka vazhduar të bëjë monitorimin e ndërmarrjeve të privatizuara me Spin Off Special edhe përkundër faktit se pjesa dërmuese e tyre janë jashtë afatit të rregullt të periudhës për zotime. Bazuar në raportet tremujore të paraqitura nga blerësit, Njësia për Monitorim ka angazhuar auditorët e jashtëm të pavarur, për të bërë auditimin e përbushjes së kushteve në përputhje me Marrëveshjen e Zotimeve për Ndërmarrjen e Re “Agrokosova Holding”, “Hotel Iliria”, “Minex”.

Prej ndërmarrjeve të privatizuara me Spin off Special janë edhe dy ndërmarrje të cilat në bazë të raportimeve të tyre që kanë bërë në Njësinë për kontroll dhe mbikëqyrje, në bazë të vizitave që janë bërë tek këto ndërmarrje dhe bazuar në raportin e Auditorëve kanë bërë përbushjen e kushteve të kontratës prandaj, ato janë ndërmarrjet e reja “Hotel Iliria”, dhe “Minex”.

Ndërmarrja e Re “Fan” Podujevë me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur me datën 20 janar 2012 është liruar nga kushtet e Marrëveshjes për Zotime.

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në Valën e 11-të të shitjes, ndërsa periudha e përbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 gusht 2008. Kjo ndërmarrje ka qenë e privatizuar nga McCroft Tobacco por pasi që gjatë periudhës së zotimeve blerësi nuk ka arritur të bëjë përbushjen e kushteve të kontratës, Bordi i AKP-së ka formuar një Komision i cili kishte për qëllim eksplorimin e të gjitha mënyrave të mundshme për të gjetur zgjidhje për zotimet e pa-përbushura, përfshirë shqyrtimet e mundshme të zotimeve ekzistuese i cili me 27 mars 2012 ka propozuar Marrëveshjen për Përtëritje (Novacion) të Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re “IDGJ

Tobacco” Shpk. Sipas marrëveshjes së re Aksionet e McCroft Tobacco i merr Ndërmarrja “Premium Tobacco Group” L.L.C e cila edhe ka lidhur Marrëveshjen e Novacionit me Bordin e AKP-së lidhur me përbushjen e zotimeve gjatë periudhës Kontraktuale. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datë 12 prill 2012, ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj Investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e Monitorimit përfundon me 12 prill 2014. Deri më tani kjo Ndërmarrje ka dorëzuar dy Raporte tre mujore si dhe janë bërë 5 vizita monitoruese tek kjo ndërmarrje. Ndërmarrja në fillim ka pasur vështirësi me hyrjen në objektet e saj dhe kjo ka ndikuar sipas tyre që deri më tani nuk kanë arritur të bëjnë përbushjen e zotimeve rreth punësimit të cilat i kanë marrë përsipër me rastin e nënshkrimit të kontratës për Përtëritje (Novacion).

Ndërmarrja e Re “Jugoterm International” është privatizuar përmes Spin Off Special në Valën e 15 të shitjes, ndërsa ratifikimi i Kontratës është bërë me 17 prill 2012, pas vendimit të Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme. Zotimin për Investime obligohet ta përbushë brenda periudhës dy vjeçare në vlerën prej €2,760,000.00, ndërsa zotimin për punësim të 282 punëtorëve, obligohet ta përbush duke punësuar 141 punëtorë në gjashtë-mujorin e parë të vitit të parë dhe 141 punëtorë shtesë në gjashtë mujorin e dytë të vitit të parë. Blerësi është i obliguar të mbajë këtë numër të punëtorëve (282) deri në përfundimin e Zotimit në bazë të Kontratës. Gjatë vitit 2012 kemi bërë katër vizita monitoruese dhe nga raportet e dorëzuara nga Blerësi dhe vizitat e zhvilluara theksojmë se Blerësi është duke iu përbajtur kushteve të marra përsipër me rastin e privatizimit të kësaj ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re “Grand Hotel” pasi që blerësi nuk ka përbushur kushtet e kontratës lidhur me investime dhe punësim, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datën 16 dhjetor 2011 ka marrë vendim për ushtrimin e kthimit të Aksioneve të Ndërmarrjes së Re Hotel Grand dhe transferimin e tyre në AKP, poashtu ka vendosur që vendimi i tillë të mos ekzekutohet menjëherë, por ka themeluar një Komision i cili ka pasur mandat për t’i udhëhequr negociatat me blerësin e Hotelit Grand për të gjetur ndonjë rrugë e cila do të mundësonte përbushjen e zotimeve nga ana e blerësit. Pas dhënies së mundësive të shumta nga ana e Komisionit dhe e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, blerësi në vazhdimësi

ka dështuar të sjellë dëshmi bindëse për mundësinë e përmbushjes së zotimeve, apo për arritjen e ndonjë marrëveshje me ndonjë investitor potencial i cili do të mundësonte përmbushjen e zotimeve të marra përsipër. Andaj, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 31 maj 2012 ka vendosur që ta ekzekutoj vendimin për kthimin e aksioneve të datës 16 dhjetor 2011. Ndërmarrja është futur në Administrim të Drejtëpërdrejtë me vendim të Bordit të Drejtorëve me datën 20 korrik 2012. Gjatë periudhës së Administrimit të Drejtëpërdrejtë, ne kemi menaxhuar inkasimin e një pjese të borxhit të vjetër, kemi realizuar disa obligime të krijuara gjatë kësaj periudhe, riprogramimin e borxhit me Ndërmarrjet Publike, KEK-un, PTK-n, TERMOKOS-in etj. dhe kemi gjeneruar të ardhura nga shërbimet e Hotelit nga të cilat kemi arritur të paguajmë pagat e 5 (pesë) muajve dhe një gjysmë page për muajin shkurt për 87 punëtorë të Ndërmarrjes së Re. AD ka përpiluar listën e asetëve që mund të lëshohen me qira dhe ka publikuar shpalljen disa herë. Varësisht nga vlerësimi i kryer nga komisioni përkatës, Ndërmarrja ka arritur të realizoj kontratat e qiradhënies, të bëjë ritenderimin e këtyre asetëve duke bërë përpjekje të krijoj të ardhura më të qëndrueshme. Gjithsej 23 asete janë dhënë me qira (duke përfshirë: dyqanet, zyrat dhe hapësirat tjera) duke gjeneruar gjithsej të hyra mujore në shumë prej €15399.00. Ne jemi në proces të rishpalljes së qiradhënies për disa zyra në katin e tretë, të cilat tashmë janë publikuar njëherë por nuk kishte interesim. Gjithashtu, kemi pranuar disa oferta për qiramarrjen e restoranteve në katin e parë.

Megjithatë, shpenzimet që dalin nga përpjekjet për grumbullimin e të ardhurave ishin të larta, siç janë shpenzimet e ngrohjes së ujit, shpenzimet e ngrohjes, rryma, të cilat ishin të domosdoshme në vazhden e shërbimeve të hotelit.

AD ka dërguar njoftimet të gjitha ambasadave që funksionojnë në Kosovë; ministrive dhe organizatave tjera qeveritare dhe jo-qeveritare duke iu dorëzuar në këtë mënyrë ofertën për shërbime cilësore dhe çmime të arsyeshme në Hotelin Grand. Administrimi i Drejtëpërdrejtë ia ka arritur të aktivizoj qasjen tek furnizimi me ujë, linjat telefonike dhe internetin (wireless).

4 (katër) kontrata për furnizim me bukë, mish, derivate dhe artikuj ushqimor janë nënshkruar gjatë periudhës nëntor 2012 – mars 2013.

Që nga momenti i vendosjes së Ndërmarrjes në AD, ajo kishte gjithsej 1.778 fjetje. Ajo është modeluar dhe është rritur numri i dhomave në 170 (të gatshme për shfrytëzim) me 270 shtretër.

Aq më tepër, kjo ndërmarrje gjithashtu ka probleme ligjore pasi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka aprovuar kërkesën e ish blerësit për masë të përkohshme për të

ndaluar transferin e aksioneve. Pas vendimit të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për aplikimin e masës së përkohshme që parandalon AKP-në nga transferi i aksioneve të Ndër të Re “Hotel Grand Prishtina” tek palët e treta, AKP do të pres përfundimin e masës së përkohshme për të vendosur Ndërmarrjen në privatizim nëpërmjet likuidimit. Dhoma e Posaçme ka lëshuar vendimin i cili ka refuzuar padinë e ish blerësit. Ish blerësi ka parashtruar ankesën tek paneli i Dhomës së Posaçme. Rasti është në pritje.

Ndërmarrja e Re “XIM Strezovc” pas dështimit të blerësit që të sjellë dëshmi bindëse për arritjen e ndonjë marrëveshje me ndonjë investitor për përmbushjen e zotimeve të marra përsipër me marrëveshjen e zotimeve e cila është pjesë përbërëse e kontratës së privatizimit me Spin Off Special dhe pasi që blerësi ka dështuar të përmbushë kushtet e marrëveshjes së zotimeve, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur me 12 mars 2012 ka vendosur që vendimi për kthimin e aksioneve të datës 16 dhjetor 2011 të hyjë në fuqi me datën 15 mars 2012. Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Administrimit të Drejtëpërdrejtë ka ekzekutuar vendimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vendosjen e Kontrollit të Drejtëpërdrejtë mbi Ndërmarrjen.

Pas tërheqjes së aksioneve Menaxhmenti i AKP-së ka ekzekutuar vendimin e Bordit duke kthyer pronësinë e aksioneve edhe formalisht përmes ndryshimeve në Regjistrin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Sipas certifikatës se re pronar i aksioneve të ndërmarrjes së re figuron Agjencia Kosovare e Privatizimit. Paralel me këtë veprim janë bërë edhe ndryshimet kadastrale tek rubrika e pronarit dhe shfrytëzuesit të pronës.

Pas takimeve të shumta, konsultimeve, dhe bashkëpunimit me Udhëheqësit e Ndërmarrjes, Sindikatën e Pavarur të Ndërmarrjes së re, dhe pas analizimit të dokumenteve relevante dhe historikut të punëtorëve të kësaj Ndërmarrjeje, në pajtim me nenin 6 të ligjit të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së, ka propozuar listën me emra për përbërjen e Bordit të përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes. Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar propozimin për emërimin e Bordit të përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes së re.

Ndërmarrja e re është propozuar në biznes planin për privatizim gjatë vitit 2013. Asetet e saja janë duke u ruajtur nga kompania e sigurimit e kontraktuar nga AKP-ja. Menaxhmenti ka identifikuar disa burime të hyrash të cilat Ndërmarrja mund t’i shfrytëzoj deri në momentin e privatizimit për të paguar pagat e punëtorëve dhe detyrimet tjera ndaj shërbimeve komunale.

Ndërmarrja e Re “Miniera dhe Industria e Magnezit Golesh” është privatizuar me 11 dhjetor 2007 nga blerësi IMING d.o.o, përmes metodës së Spin Off-it Special në Valën e 22-të të shitjes, ndërsa Marrëveshja për Zotime ka përfunduar me datën 11 dhjetor 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej €16,200,000 si dhe të punësoj 178 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 355 punëtorë. Në mars të vitit 2012, AKP ka angazhuar kompaninë vlerësuese “Aurelian Capital” L.L.C, që të bëjë vlerësimin e investimeve të kryera në Ndërmarrjen e Re MIM Golesh. Nga të gjeturat e prezantuar në raportin e vlerësimit rezulton se blerësi ka bërë investime në shumën prej €13,376,223.59. Në takimin e muajit mars Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka vendosur që të pezulloj ekzekutimin e vendimit të Bordit të datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve, ndërsa në mbledhjen e Bordit të mbajtur me datën 31 maj 2012 afati për përbushjen e obligimeve për MIM Golesh zgjatet për dy vite nga data e nënshkrimit të kontratës. Gjatë vitit 2012 kemi zhvilluar një vizitë monitoruese tek kjo ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re “NBI Suhareka/Agrokosova Holding” është privatizuar me 27 gusht 2007 nga Blerësi “Gruppo Vinicolo Fantinel” dhe “QMI” përmes metodës së Spin Off-it Special në Valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej €8,600,000 si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 345 punëtorë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKP-ja ka angazhuar auditorë të jashtëm për të audituar përbushjen e kushteve të marrëveshjes së zotimeve nga blerësit e Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding”. Sipas raportit të auditorit të jashtëm blerësi i ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding” ka përbushur kushtin për investime kapitale në nivelin 88.87% ndërsa atë për punësim 39%. Nisur nga fakti se kemi mospërbushje për punësim dhe investime edhe Bordi i AKP ka marre parasysh këtë dhe është në vlerësim të kësaj mospërbushje. Gjithashtu në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të mbajtur me datën 20 korrik 2012 Bordi ka vendosur që vendimi i Bordit i datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve të mbetet në fuqi por të shtyhet ekzekutimi i këtij vendimi për 6 muaj dhe në ndërkohë të angazhohet një kompani që të bëjë vlerësimin e investimeve të bëra në këtë ndërmarrje dhe pastaj të rishikohet vendimi i Bordit për tërheqjen e aksioneve.

Gjithashtu, Njësia për Monitorim ka angazhuar edhe kompaninë vlerësuese, me qëllim që të bëjë vlerësimin e aseteve për Ndërmarrjen e Re MIM Golesh dhe XM Strezovc. Raporti i vlerësimit për këtë ndërmarrje është pranuar dhe i njëjti është prezantuar Bordit të Drejtorëve për shqyrtim.

Në të njëjtën kohë Njësia për Monitorim ka vazhduar të dërgojë faturat mujore për ndëshkime financiare për pesë ndërmarrjet e ndëshkuara për mospërbushje të kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Për periudhën kohore 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012, shuma e përgjithshme e ndëshkimeve financiare për këto ndërmarrje është si vijon:

Shuma totale e ndëshkimeve për 5 SOS-të prej 01/01/2012 deri me 31/12/2012	
Ndër e Re Grand Hotel	€740,687.51
Ndër e Re IDGJ Tobacco	€90,822.48
Ndër e Re Xim Strezovc	€283,238.52
Ndër e Re MIM Golesh	€321,648.60
Ndër e Re Agrokosova Holding	€217,102.73
Totali	€1,653,499.84

NDËRMARRJET E PRIVATIZUARA ME KUSHTE

Gjatë periudhës 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012, 9 ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës - kryesisht vazhdimin të aktivitetit të njëjtë të biznesit.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Statusi
1	Ndërmarrja e Re Sharrcem	Nën monitorim
2	Ndërmarrja e Re Remont Servis	Nën monitorim
3	Ndërmarrja e Re Hotel Union	Nën monitorim
4	Ndërmarrja e Re Llamkos	Nën monitorim
5	Ndërmarrja e Re Famipa	Nën monitorim
6	Ndërmarrja e Re Amortizatorët	Nën monitorim
7	Ndërmarrja e Re Dubrava DF	Nën monitorim
8	Ndërmarrja e Re Emin Duraku - Edico	Nën monitorim
9	Ndërmarrja e Re Emin Duraku - Kl	Nën monitorim

Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është privatizuar me 09. 12. 2010 për shumë 30.1 milion euro, ndërsa sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 viteve të ardhshme të gjithë ish punonjësit e ndërmarrjes (numri i punonjësve 503). Blerësi i ndërmarrjes vetëm gjatë vitit të parë ka raportuar një shumë të konsiderueshme të investimeve kapitale (€11,552,140.08) ndërsa vazhdon të punësoj të njëjtin numër të punonjësve (503 punonjës). Raportet e dorëzuara nga blerësi janë subjekti i auditimit të jashtëm. Gjatë vitit 2012 kemi bërë dy vizita monitoruese tek kjo ndërmarrje dhe në bazë të raporteve të pranuar dhe vizitave të bëra mund të theksojmë se kjo ndërmarrje është duke zhvilluar aktivitetin në përputhje me kushtet e kontratës. Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është e obliguar ti raportoj AKP-së deri 09 dhjetor 2015.

Ndërmarrja e Re “Remont Service” është privatizuar në Valën 45A, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar më 13 qershor 2011. Kontrata e privatizimit për “Remont Service”, përmban kushtin për punësimin e 43 punëtorëve për një periudhë dy vjeçare – kusht i cili është transferuar nga kontrata e koncesionit në kontratën e shitjes. Ndërmarrja e re “Remont Servisi” është një nga ndërmarrjet e privatizuara me kushte e cila deri më tani me mjaft sukses ka arritur të

plotësoj kushtet e kontratës, blerësi i ndërmarrjes deri më tani çdo tre muaj ka raportuar brenda afatit kohor të paraparë me kontratë dhe në disa raste ka raportuar se ka punësuar më shumë punonjës se sa ka qenë i obliguar sipas kushtit të kontratës për punësim. Gjatë vitit 2012 janë bërë tri vizita monitoruese. Ndërmarrja e Re “Remont Servisi” është e obliguar ti Raportoj AKP-së deri 08 qershor 2013.

Ndërmarrja e Re “Llamkos Steel” është shitur në Valën 6 të shitjes përmes Likuidimit, ndërsa ratifikimi i Kontratës së Shitjes është bërë me datën 25 gusht 2011. Bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes së aseteve dhe Planin e Biznesit, blerësi i Ndërmarrjes së re Llamkos ka marrë përsipër që të punësoj 437 punonjës 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës si dhe të bëjë investime në vlerë prej 25 mil Euro vetëm gjatë dy viteve të para të veprimtarisë.

Blerësi i ndërmarrjes gjithashtu merr përsipër të zbatoj edhe dy faza të tjera investimesh, gjatë fazës së dytë (18 muaj pas përfundimit të fazës së parë) do të investohen edhe 45 mil Euro ndërsa gjatë fazës së tretë (18 muaj pas përfundimit të fazës së dytë) do të investohen edhe 30 mil Euro të tjera.

Ndërmarrja e re “Llamkos” është duke vazhduar aktivitetin e vet prodhues. Deri tani drejtuesit e ndërmarrjes kanë paraqitur një raport 6 mujor lidhur me vazhdimin e aktivitetit të njëjtë të biznesit si dhe raportin vjetor lidhur me investimet dhe punësimin e realizuar.

Nga ky raport rezulton se blerësi është duke plotësuar kushtet e kontratës, blerësi ka raportuar 438 punonjës të punësuar me orar të plotë ndërsa në anën tjetër ka raportuar investime në vlerë prej €11,442,729.15. Gjatë vitit 2012 janë bërë tri vizita monitoruese tek kjo ndërmarrje.

Raporti i radhës për investime dhe punësim pritet të pranohet me 25 gusht 2013. Raporti për vazhdim të aktivitetit 25 shkurt 2013. Ndërmarrja e Re “Llamkos” është e obliguar të raportoj në AKP deri më 25 gusht 2016.

Ndërmarrja e Re “Famipa” është privatizuar në Valën 49 të shitjeve, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 shtator 2011.

Shtojca 5 – Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re “Famipa” do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja të paktën deri në përfundim të kontratës.

Gjatë vitit 2012 janë bërë tri vizita monitoruese nga të cilat mund të theksojmë se kjo ndërmarrje është duke zhvilluar një aktivitet të vogël edhe përkundër disa planeve që ka paraqitur dhe mendojnë ti realizojnë në të ardhmen.

Raporti i radhës lidhur me vazhdimin e aktivitetit pritet të pranohet me 13 mars 2013. Ndërmarrja e Re “Famipa” është e obliguar të raportoj në AKP deri më 13 shtator 2014.

Ndërmarrja e Re “Hotel Union” është privatizuar në Valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 gusht 2006.

Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3 blerësi i Ndërmarrjes së Re është zotuar se do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht do të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe ti siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m² për 13 vitet e ardhshme.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” është privatizuar në Valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 mars 2011. Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Gjatë vitit 2012 janë bërë 5 vizita monitoruese nga të cilat mund të përfundojmë se ndërmarrja zhvillon aktivitetin prodhues sipas kërkesave individuale por jo edhe ndonjë prodhim serik të amortizatorëve.

Periodha e Monitorimit përfundon me 31 mars 2016.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 shtator 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” Sh.p.k. gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 03 shtator 2017.

Deri më tani kemi bërë një vizitë monitoruese nga e cila nuk shihet ndonjë lëvizje rreth përbushjes së kushteve të parapara me kontratën e shitblerjes. Në bazë të marrëveshjes së shitjes ndërmarrja në vitin e parë duhet të raportoj çdo tre muaj, ndërsa gjatë viteve të tjera çdo gjashtë muaj.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 gusht 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 gusht 2017.

Gjatë kësaj periudhe duhet të raportoj tek Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes çdo gjashtë muaj. Deri më tani kemi bërë një vizitë monitoruese nga e cila mund të përfundojmë se Blerësi nuk ka filluar asnjë aktivitet në ndërmarrje me arsyetim se një pjesë e objektit është e uzurpuar si dhe makineria iu është dëmtuar shumë.

Blerësi ka bërë kërkesë tek Bordi i AKP – së që ti mundësohet ndërrimi i llojit të prodhimit nga ajo e lëkurës në atë të tekstilit ngase makineria që ka mbetur nuk mundëson zhvillimin e prodhimit që është bërë me parë aty.

Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” është privatizuar në Valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” gjendet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i Ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” është e obliguar të mbaj të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbaj 250 krerë gjedhe për ketë periudhë kohore në bazë të Kontratës. Është pranuar raporti 6 mujor Kuartal Q1, ku ka raportuar për përbushjen e Zotimeve.

Bazuar në Raportet Kuartale, Blerësi ka investuar në blerjen e 250 krerë gjedheve dhe ka punësuar 17 punëtorë në bazë të Kontratës. Gjatë vitit 2012 janë bërë 4 vizita monitoruese.

NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITORË

Raporti i Njesisë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë për periudhën janar-dhjetor 2012 në përputhje me Planin Vjetor të Punës së AKP-së përfshinë aktivitetet e parapara mbi realizimin e objektivave të përgjithshme.

Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë ka siguruar përkrahje të plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP-ja, përfshirë: lansimin e shitjeve, mbikëqyrjen e përgatitjeve për reklamim, realizimin e të gjitha materialeve promovuese, si dhe ka ofruar shërbime këshillimi për të gjithë investitorët e interesuar në procesin e privatizimit.

Iniciativat e Reja të Marketingut

- Promovimi i Procesit të Privatizimit - njësia për marketing ka lidhur marrëveshje me disa nga revistat më të specializuara ndërkombëtare për promovimin e privatizimit, përfshirë: botimi special i revistës Succeed, që do të shpërndahet në fluturimet Vjenë-Prishtinë gjatë muajit shkurt 2013, me rastin e 5 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës; Europe's World magazina dhe revista Expert, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe British Council; Broshura promovuese e publikuar nga Kosovo American Education Fond (KAEF).
- SMS Shërbimi - për herë të parë këtë vit është implementuar njoftimi përmes SMS shërbimit, çka ka rezultuar me efekte shumë pozitive në shpërndarjen e informatës tek palet relevante. Me fillimin e përdorimit të SMS shërbimit, në bazë të statistikave të nxjerra, vizitueshmëria e web faqes ka arritur rekord në muajin Shkurt, çka edhe mund të konsiderohet si indikator i suksesit për metodën e përdorur.
- Posterë për Identifikimin e Pronave/Lokaleve në Shitje - njësia për marketing ka përgaditur posterë njoftues të cilat janë vendosur nëpër lokale/prona që aktualisht janë për shitje. Vendosja e tyre ka mundësuar identifikimin më të lehtë të pronave/lokaleve për palë e interesuara, e që njëkohësisht kjo metodë është shfrytëzuar edhe si mjet promovues.
- Video Udhëzues dhe Video Dokumentarë - me qëllim të përmirësimit të shërbimit dhe sigurimit të qasjes sa më të lehtë në informata të duhura për përgatitje të dokumentacionit ofertues është realizuar video-udhëzuesi, i cili është postuar në webfaqe dhe ju është dhënë investitorëve potencial. Video dokumentarët e

realizuar, posaçërisht për projektet individuale, kanë mundësuar investitorëve të interesuar që ta njohin historinë e ndërmarrjes, përfshirë procesin, veprimtarinë, prodhimet, kapacitetet etj, gjë që ka ngritur interesim për pjesëmarrje në privatizim.

- Pllakat – në ditën e Ceremonisë së Dorëzimit dhe Hapjes së Ofertave Njësia për Marketing ka vendosur pllakate me përmbajtjen “Si duhet të Përgadisë Ofertën”, duke i njoftuar edhe njëherë pjesëmarrësit para dorëzimit të ofertës mbi përmbajtjen e ofertës me dokumentacion përkatës.
- Anketa – Njësia për Marketing ka përgaditur anketë e cila ju është ofruar investitorëve potencial për të shprehur mendimin mbi cilësinë e shërbimeve të marra. Pas vlerësimeve të marra brenda një periudhe, janë reflektuar avancime, gjë që ka rezultuar në përmirësimin e shërbimeve tona.

Aktivitetet tjera të Marketingut

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investitorëve ndërkombëtar, rajonal dhe lokal, janë realizuar rreth njëzet (20) materiale të shtypura promovuese, përfshirë: Broshurën gjenerale për Privatizim, fletushkat për Ndër e Re Virxhinia, XIM Strezoci, Boksitet, Grand Hotel, dizajnimin e ligjit të AKP-së në format të xhepit, regjistrator, zarfa, CD, DVD, pllakate, lapsa si dhe të gjitha shpalljet për gazetata lokale, ndërkombëtare dhe revistat e specializuara.

Njësia për marketing dhe marrëdhënie me investitor ka ofruar shërbime këshillimi në lidhje me procesin e Privatizimit përfshirë: informata, parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj).

Me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit si dhe projekteve individuale, zyrtarët e marketingut kanë përfaqësuar AKP-në në ngjarje të ndryshme, përfshirë:

Panairin ndërkombëtar EXPOKOS 16-19 maj dhe panairin e përgjithshëm ndërkombëtar PRISHTINA 2012, me datat 06-09 qershor të mbajtur në Prishtinë; Takimi vjetor i investitorëve për agrobiznese dhe prezantimi i mundësive për privatizim të tokave bujqësore, organizuar nga USAID; Panairi AGROKOS dhe festivali "Food & Drink Fest" 29 tetor 01 nëntor 2012, Pallati i Rinisë, Prishtinë; Eventi i organizuar nga OEK me delegacion nga Shoqata e Biznesmenëve dhe Industrialistëve të Trabzonit, prezantimi i AKP-së si dhe takime bilaterale me anëtarët; Prezantimi i AKP-së dhe takime me Shoqatën e Eksportuesve dhe Odën Ekonomike të Greqisë Veriore, në B2B eventin e organizuar nga Zyra Ndërlidhëse Greke, në Selanik.

Shpallja e Valëve 54, 55 dhe 56 dhe Shitjeve të Aseteve 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18

Për lansimin e Valëve të Privatizimit dhe Shitjen e Aseteve janë përfshirë aktivitete si:

- Përmbledhja e materialeve relevante në koordinim me zyret rajonale dhe Njësinë për Përgatitjen e Tenderëve.
- Mbikqyrja e realizimit të tetë (8) TV reklamave dhe dizajnimi i njëmbëdhjetë (11) shpalljeve për gazeta lokale.
- Lansimi është bërë përmes publikimit të shpalljeve në të gjitha gazetat lokale, përmes webfaqes së AKP-së dhe transmetimit të TV Reklamës në tri Televizionet Kombëtare RTK, RTV 21 dhe KTV.
- Investitorët e parakualifikuar janë njoftuar përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
- Publikimi i njoftimeve të shkurtëra rreth afateve për parakualifikim dhe datës për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve.

Shpallja e Shitjeve: (Hotel Onix Banja e Pejës dhe Ilixhe dhe Fabrika e Baterive Industriale Trepça 20 Prill 2012; Fabrika e Duhanit Virxhinia – 24 Gusht 2012)

- Njoftimi mbi lansimin e projekteve është dërguar tek të gjitha gazetat lokale dhe në revistën e mirënjohur ndërkombëtare The Economist;
- TV reklama është transmetuar në tri Televizionet Kombëtare RTK, RTV 21, KTV;
- Shpallja dhe dokumentari janë vendosur në webfaqen e AKP-së;
- Investitorëve të parakualifikuar u është dërguar njoftim përmes e-mailit;
- Materiali promovues është dërguar te institucionet relevante – odat e huaja ekonomike dhe ambasadat;

Për promovimin e projekteve individuale është shfrytëzuar edhe platforma promovuese e Agjencionit për Promovim të Investimeve të Kosovës (APIK). Strategjia e zgjedhur e marketingut ka qenë strategji e marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt.

Me rastin e lansimit të shitjes, është organizuar konferenca për shtyp, në të cilën kanë qenë të ftuar të gjitha Ministrinë relevante dhe Odat e huaja ku janë prezantuar materiale promovuese (broshura atraktive, TV reklama dhe dokumentarë të shkurtër) dhe u është bërë ftesë investitorëve për investim.

Ativitetet e Marketingut dhe Aktivitetet Promovuese për Projektet Individuale

- Investitorëve potencial strategjik u është dërguar me postë dhe përmes e-mailit ftesa për pjesëmarrje në privatizim, përfshirë shoqatave të operatorëve profesional të industrive përkatëse për shpërndarje tek anëtarët e tyre;
- Në koordinim me Ministrinë e Punëve të Jashtme janë shpërndarë materiale promovuese tek ambasadat e Kosovës në shtetet e jashtme;
- Janë mbajtur takime me përfaqësuesit e institucioneve relevante për shpërndarje të informacionit dhe mundësinë e privatizimit të Virxhinisë, përfshirë: 1) Ministria e Zhvillimit Ekonomik; 2) Ministria e Punëve të Jashtme – Departamenti i Zhvillimit Ekonomik; 3) NOA – USAID projekt; 4) Ministria e Diasporës; 5) MBPZHR për shpërndarje të informatave tek komuniteti i agrobiznesit; 6) OEK - me qëllim të shpërndarjes së informacionit tek 35 anëtarë regjional të odës në sferën e agrobiznesit.
- Promovimi i projekteve individuale në panairin ndërkombëtar EXPOKOS, me datat 16-19 maj dhe në panairin e përgjithshëm ndërkombëtar PRISHTINA 2012.
- Takime me investitorë, nënshkrimi i Marrëveshjeve për Ruajtjen e Sekretit Afarist;
 - a) Hotel Onix: Marrëveshje të nënshkruara në total 7;
 - b) FBI Trepça: Marrëveshje të nënshkruara në total 5.

Shpallja e Rezultateve të Parakualifikimit për Projektet Individuale

Në bazë të Rregullave të Tenderit, vlerësimi i kërkesave për parakualifikim është bërë nga ana e Komisionit Vlerësues, të emëruar nga Bordi i AKP-së. Sipas vendimit të Komisionit numri i ofertuesve potencial të parakualifikuar janë:

- Hotel Onix: 3 (1 refuzim)
- FBI Trepça: 2 (1 refuzim)
- Virxhinia: në bazë të aktvendimit të OVGJ janë ndërprerë procedurat e tenderimit

Vizita në terren dhe sesioni Q&A për Hotel Onix dhe FBI Trepça me ofertuesit e parakualifikuar është realizuar në dy pjesë: vizita e pronës dhe takimi me panelin (AKP dhe NSH) i cili përfshinë:

- a) Zyrtarin e zyrës së marketingut - informata rreth procedurës së ofertimit;
- b) Zyrtar të administrimit të drejtpërdrejtë/kadastral - informata rreth pronës se përfshirë në tender;
- c) Menaxhmenti i NSH – informata për çështje teknike te operimit.

Web Faqja

Njësia e Marketingut ka populluar webfaqen me të gjitha informatat dhe dokumentet relevante te AKP-së, përfshirë lansimin e Valëve të Privatizimit dhe Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtoreve për shpërndarjen e 20%, raporte përfundimtare te likuidimit, komunikata për

media, konkurse për punë, rezultatet dhe vendimet për shitjet e asetëve, si dhe informata tjera të rëndësishme.

Në vitin 2012 është rritur vizitueshmëria e webfaqes në mënyrë të dukshme në krahasim me vitin paraprak 2011 (243,897 vs 41,701 vizitorë).

Marrëdhënie me Investitor

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë në vazhdimësi ka pasur takime me investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, që ka rezultuar me:

- 467 investitorë të rinj të parakualifikuar gjatë vitit 2012

Mbi 1,600 marrëveshje për ruajtjen e sekretit afarist të nënshkruara me palët e interesuara për pronat dhe asetet e tenderuara në shitje gjatë këtij viti.

DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT

Divizioni i Likuidimit është njëra prej dy shtyllave të AKP-së i cili merret me procesin e likuidimit të NSH-ve. Divizioni i Likuidimit koordinon punët dhe detyrat në mes Zyrës Qendrore dhe Departamentit të Likuidimit së bashku me udhëheqësit e ekipeve të likuidimit në zyrat rajonale të AKP-së. Pas procedurave të tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës më datë 10 korrik 2012 është angazhuar konzorciumi Deloitte dhe Tashko&Pustina për projektin “Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portfolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës”, kontratë e cila menaxhohet nga Departamenti i Likuidimit, në kuadër të Divizionit të Likuidimit.

DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT

Departamenti për Koordinim të Likuidimit është drejtëpërdrejtë i kyçur në zbatimin dhe monitorimin e procesit të Likuidimit të NSH-ve, qoftë për likuidimin e NSH-ve nga Ofruesi i shërbimeve profesionale, apo Likuidimin e NSH-ve pa asete dhe kërkesa të kreditorëve që kryhen nga njësia për likuidimin e NSH-ve në kuadër të AKP-së, konform

legjisllacionit në fuqi. Departamenti për Koordinim të Likuidimit përbëhet nga këto katër njësi:

- Njësia e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondeve të Mbetura
- Njësia e Likuidimeve nga AKP-ja
- Njësia për Listat e Punëtorëve dhe
- Njësia e Tranzicionit.

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë për ri-fillimin e procesit të likuidimit me vendim të drejtorit menaxhues të Agjencisë janë emëruar pesë komisione me qëllim të rikategorizimit të kërkesave të kreditorëve bazuar në ligjin e ri mbi AKP-në, për të gjitha ndërmarrjet shoqërore në likuidim.

NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA

Aktivitetet kryesore të Njesisë së Monitorimit të Likuidimit dhe Fondeve të Mbetura për periudhën raportuese mund të përmbliken si në vijim:

a) Autoritetet e Likuidimit

Në mbledhjen e mbajtur më 21 qershor 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka marrë vendim për themelimin e Autoriteteve të Likuidimit (AL) të ndërmarrjeve që tanimë janë në likuidim, dhe shuarjen e Komisioneve të Likuidimit (KL-ve). Bazuar në këtë vendim gjatë vitit 2012, është bërë emërimi i Autoriteteve të Likuidimit për 173 NSH në likuidim. Me rastin e emërimit të AL-ve për ndërmarrjet përkatëse, janë shuar të gjitha aktivitetet e Komisioneve të Likuidimit (KL-ve) më parë të emëruara, dhe të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë i janë bartur AL-ve. Gjithashtu është bërë pranim dorëzimi i këtyre kompetencave nga KL-ja në AL.

b) Aktivitetet tjera

Departamenti për Koordinim të Likuidimit vazhdimisht ka vizituar Zyrat Rajonale me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe trajnimit të stafit në këto zyra për fusha të ndryshme lidhur me procesin e likuidimit si:

- i. Popullimi i Sistemit të Menaxhimit të AKP-së me të dhënat (aplikacioni), në modulën e Likuidimit,
- ii. Ofrimi i informatave dhe përgatitja për punë me Autoritetin e Likuidimit, etj.

Gjithashtu në vazhdimësi janë mbajtur takime koordinuese me Udhëheqësit e Ekipeve të Likuidimit (UEL) në të cilat takime janë diskutuar dhe shpjeguar çështje të ndryshme rreth procesit të likuidimit si:

- Përfundimi i verifikimit të kategorizimit të kërkesave sipas raportit të Komisioneve për Verifikimin e Kategorizimit të Kërkesave;
- Përgatitjet e duhura për rifillim të procesit të likuidimit dhe emërimet e Autoriteteve të Likuidimit (AL) për të gjitha NSH-të në likuidim;

- Koordinimi i punëve me Autoritetin e Likuidimit - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP);
- Prezantimi i Raportit Fillestar nga Autoriteti i Likuidimit sipas kontratës;
- Emërimi i zyrtarëve të rastit dhe detyrat e tyre për NSH-të në Likuidim;
- Faza deri ku kanë arritur NSH-të e propozuara për shpërndarje finale/mbyllje;
- Bashkëpunimi me stafin e Autoritetit të Likuidimit - Ofruesit e Shërbimeve Profesionale, etj.

AUTORITETI I LIKUIDIMIT - OFRUESIT E SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Në përputhje me Ligjin e ri (04/l-034) AKP-ja ka angazhuar konzorciumin Deloitte dhe Tashko&Pustina për projektin “Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portfolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës” me ç’rast më 10 korrik 2012 është nënshkruar kontrata në mes të palëve. Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës Autoriteti i Likuidimit është informuar në detaje lidhur me procesin e likuidimit dhe pastaj sipas nevojës:

- Është bërë prezantimi i aplikacionit dhe vizitat në zyrat rajonale; Është furnizuar kontraktori me të gjithë dokumentacionin relevant lidhur me procesin e likuidimit;
- Është furnizuar kontraktori me të gjithë dokumentacionin relevant lidhur me procesin e likuidimit,
- Është krijuar qasja e nevojshme edhe në aplikacion edhe në arkiva dhe është bartur i tërë dokumentacioni dhe baza ligjore relevante (Ligji për AKP-në, politika operacionale, udhëzuesi për likuidim, ligjet tjera relevante, arkiva e gazetave zyrtare, etj) me qëllim që të përdoren nga Autoriteti i Likuidimit gjatë procesit të likuidimit sipas procedurave në procesin e likuidimit.

Në fillim të punës Autoriteti i Likuidimit ka analizuar situatën

për 173 NSH-të në likuidim dhe ka filluar punën me pilot ndërmarrje për t’u studiuar hollësisht në ZR të Mitrovicës dhe Prishtinës (nga 2 ndërmarrje në likuidim nga secila zyre).

Kontraktori ka prezantuar raportin fillestar (sipas kontratës me datë 8 shtator 2012) ku përveç përshkrimit të gjendjes së ndërmarrjeve në likuidim janë bërë edhe propozimet dhe planet se si do të punojnë në të ardhmen.

Deri më datën e raportimit në përputhje me vendimin e Bordit janë emëruar 173 Autoritete të Likuidimit në 5 Zyrat Rajonale të AKP-së.

Mos emërimi i Bordit të AKP-së ka ndikuar në shtyrjen e disa procedurave të cilat do të përshpejtonin procesin e Likuidimit.

Po ashtu, Autoriteti i Likuidimit ka pasur ngecje në përmbushjen e detyrave, përgjegjësive dhe obligimeve nga ana e tij, prandaj krahasuar me zotimet e tyre në Raportin Fillestar, procesi i likuidimit nuk ka ecë me dinamikën e duhur gjatë kësaj periudhe kohore. Kjo ka dëshmuar një performancë jo të nivelit të duhur, të pritur, dhe në përputhje me kontratën nga ana e Kontraktorit.

Qëllimi i përgjithshëm i OSHP-së, që vepron si AL për NSH-të në likuidim, është të ofroj menaxhim efektiv të procesit të likuidimit të NSH-ve me qëllim të përmbylljes së rasteve dhe mundësisimit të shpërndarjes së fondeve kreditorëve dhe tepricën nga likuidimi, nëse ka, buxhetit të Kosovës.

Kontraktori në bashkëpunim me AKP-në, ka bërë përzgjedhjen e katër pilot NSH-ve në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë dhe në Mitrovicë dhe ato janë:

- KB Orllan (ZR Prishtinë)
- KLUZ (ZR Prishtinë)
- IMB (ZR Mitrovicë)
- Stacioni Veterinar në Skenderaj (SVS) (ZR Mitrovicë)

Këto pilot NSH janë përbërë nga ekipe të ndryshme të OSHP-së duke shqyrtuar shënime të disa NSH-ve dhe kontrollimin e vendimeve të lëshuara.

Diagrami më poshtë pasqyron tërë punën e kontraktorit - OSHP-së lidhur me shqyrtimin e ankesave duke filluar nga shqyrtimi fillestar dhe lëshimi i draft-vendimit në zyrat rajonale deri tek shqyrtimi përfundimtar nga Autoriteti i Likuidimit.




Tabela më poshtë paraqet performansën e ekipeve të Kontraktorit - OSHP-së në rajon për periudhën tetor – dhjetor 2012.

Përmbledhje e shqyrtimit të kërkesave gjatë vitit 2012						Gjithsej
Zyrat Rajonale					GJI	
PRN	MIT	PRZ	PEJ			
Gjithsej kërkesa (draft)	407	463	824	532	457	2,683
Vendime dërguara ankuesit	40	18	172	4	0	234

Numri i përgjithshëm i kërkesave të shqyrtuara nga ekipet e OSHP-së në Zyrat Rajonale është 2683 për tre muaj: tetor, nëntor dhe dhjetor 2012. Numri i përgjithshëm i vendimeve dërguar pretenduesve është 234. Hapësira ndërmjet numrit të kërkesave të shqyrtuara nga OSHP në Zyrat Rajonale dhe numri i përgjithshëm i vendimeve dërguar pretenduesve ekziston për shkak të proceseve të ndryshme ndërmjet shqyrtimit fillestar të kërkesave deri tek postimi-dërgimi i vendimeve (siç është përshkruar në diagramin më lartë, vendimi për shqyrtimin e kërkesës duhet të rishikohet dy herë (Vlerësim i Cilësisë dhe me rastin e nënshkrimit) dhe më pas duhet të përkthehet para se të postohet-dërgohet te pretenduesi). Pas përfundimit të vitit janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përshpejtuar procesin e dërgimit të vendimeve pretenduesve pa sakrifikuar procesin tonë për vlerësimin e cilësisë.

NJËSIA E LIKUIDIMIT TË NSH-VE NGA AKP

Si rezultat i procesit të ristrukturimit të strukturës organizative përbrenda AKP-së, është themeluar Njësia e Likuidimit të NSH-ve nga AKP-ja. Roli i Njesisë së Likuidimit të NSH-ve nga AKP është të bëjë koordinimin e aktiviteteve të ndryshme me Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së, lidhur me iniciimin, organizimin dhe monitorimin e proceseve të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk kanë asete ose kërkesa kreditore të parashtruara në afat dhe që rrjedhimisht janë të parapara që këto NSH të likuidohen nga AKP-ja.

Aktivitetet

Gjatë periudhës raportuese 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2012, janë katër ndërmarrje të cilat janë nën autoritetin administrativ të DKL respektivisht të Njesisë së Likuidimeve nga AKP-ja, dhe për të cilat janë realizuar procedurat në kuadër të procesit të likuidimit të NSH-ve pa asete dhe kërkesa kreditore. Lidhur me këtë, në përputhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të mbledhjes së mbajtur me datë 29 mars 2012, janë themeluar Autoritetet e Likuidimit¹ (AL) edhe për këto katër Ndërmarrjet Shoqërore. Në të njëjtën kohë është bërë edhe emërimi i anëtarëve nga stafi i AKP-së për të shërbyer në kuadër të Autoritetit të tanishëm të Likuidimit.

AL-të janë themeluar për ndërmarrjet si në vijim:

1. Kooperativa Bujqësore “LIKOVCI” – Skenderaj
2. Kooperativa Bujqësore “LIRIA” – Skenderaj
3. NSh “GRANITI” – Skenderaj
4. NSh “HIDROTERMIKA” – Mitrovicë

Me datën 16 gusht 2012, Autoritetet e Likuidimit të 4 NSH-ve (KB “Likovci”, KB “Liria”, NSh “Graniti” dhe NSh “Hidrotermika”) kanë paraqitur kërkesën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për aprovimin e Raporteve Përfundimtare të mbylljes së procesit dhe planit të riorganizimit të këtyre 4 NSH-ve, dhe për të njëjtat ka kërkuar nga gjykata të lëshojë vendim mbi lejimin e mbylljes së rasteve të likuidimit.

NSH “Hidrotermika”

Me datën 15 tetor 2012, Autoriteti i Likuidimit të NSH “Hidrotermika” ka pranuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës aktvendimin me anë të të cilit është njoftuar lidhur me aprovimin e raportit përfundimtar dhe lejimin e mbylljes së lëndës së likuidimit të NSH “Hidrotermika”. Si rrjedhojë me datën 09 nëntor 2012 (pas afatit kohor për paraqitjen e ankesave kundër aktvendimit të DhPGJS) janë dërguar njoftimet (sipas nenit 45 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së 04/L-034) tek institucionet relevante lidhur me çështjen e përmblylljes së likuidimit të NSH “Hidrotermika” në Mitrovicë, konform aktvendimit të Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Raporti përfundimtar i NSH “Hidrotermika” është publikuar në ueb faqen zyrtare të AKP-së.

¹AL – Autoritet i Likuidimit i themeluar konform nenit 9 të Ligjit të AKP-së dhe nenit 6,12 dhe 13 të shtojcës së Ligjit Nr. 04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

NSH “Graniti”

